



USHTRIA



Viti i 77-të i botimit Nr. 3 (827858)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 19 janar 2024

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike nis rrugëtim e saj në FA



» faqe 3



Dy helikopterët "Black Hawk", pjesë e Forcave të Armatosura

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi i shoqëruar edhe nga i ngarkuari me punë i Ambasadës së SHBA në Tiranë David Wisner si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji ishin në Bazën Ajrore të Farkës, ku panë nga afër dy helikopterët "Black Hawk" të mbërritur së fundmi në Shqipëri.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi shprehu mirënjohjen për mbështetjen e partnerit strategjik të Shqipërisë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, duke vlerësuar mbërritjen e dy helikopterëve si një nga kapacitetet më të rëndësishme operacionale të vendit tonë në raport me NATO.

"Këtë vit është 15-vjetori i anëtarësimit tonë në NATO dhe ne e kemi filluar me një ngjarje të madhe, mbërritja e dy helikopterëve "Black Hawk". Është vetëm fillimi. Jemi në bisedime për dy të tjerë në periudhën afatmesme dhe deri në vitin 2030 ne shpresojmë që Shqipëria të ketë një flotë prej 6 helikopterësh "Black Hawk". Është një donacion i partnerëve tanë strategjikë SHBA-të, por edhe me një pjesë nga buxheti i shtetit. Po ndërtojmë dy hangarë specifikë për helikopterët "Black Hawk", që do të përfundojnë brenda këtij viti, këtu në Bazën Ajrore të Farkës", - nënvizoi ministri Peleshi.

Bashkë me dy helikopterët "Black Hawk", sipas ministrit Peleshi, Shqipëria ka mundur të përfitojë një paketë të plotë mbështetjeje, ku përfshihen edhe mirëmbajtja për një periudhë të caktuar, asistencë teknike si dhe trajnimi i pilotëve.

"Është një model bashkëpunimi ekselent, sepse nuk është thjeshtë blerja e dy mjeteve ajrore, por bashkë me të, ne e quajmë paketë e plotë, ne blemë edhe mirëmbajtjen për një periudhë të caktuar, edhe asistencën teknike, trajnimin e pilotëve tanë. 8 pilotë janë trajnuar në SHBA përmes partneritetit shtetëror që ne kemi me Gardën e Nju Xhersit, si edhe pajisje të ndryshme



për testimin, diagnostikimin, pra është një paketë e plotë. Këtë model duam të ndjekim edhe me kapacitetet e tjera", - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

Ministri Peleshi foli edhe për helikopterët e tjerë që pritet të shtojnë Flotën tonë Ajrore. "Do të vazhdojmë të unifikojmë sa më shumë të mundim

Flotën tonë Ajrore drejt helikopterëve 'Black Hawk'. Dy helikopterët e tjerë, që ne kërkojmë të blejmë, janë fjala e fundit e helikopterëve 'Black Hawk'. Në këtë rrugë duam të ecim. Duam të shpenzojmë me shumë kujdes dhe me inteligjencë buxhetin e dedikuar prej 2% të GDP për Sigurinë dhe Mbrojtjen. Kohët që po jetojmë janë të vështira. Siguria dhe Mbrojtja janë bërë kryefjala dhe sfida e të gjitha vendeve, sidomos në rajonin tonë, që është një rajon i brishtë dhe, ndaj, e çmojmë veçanërisht këtë fuqizim të Forcës sonë Ajrore, por edhe të gjitha planet e tjera që ne kemi me parterin tonë strategjik SHBA", - theksoi ministri i Mbrojtjes.

Ndërsa i ngarkuari me punë i Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, David Wisner vlerësoi përgatitjen e pilotëve shqiptarë dhe ekipeve të mirëmbajtjes: "Kemi dëgjuar nga Uashingtoni, nga Alabama dhe gjithë trajnimet e tjera që ju keni bërë se çfarë pilotësh të shkëlqyer keni dhe sigurisht, pilotët nuk mund të fluturojnë pa patur persona që merren me mirëmbajtjen. Dhe jemi aq krenarë për të gjithë punën që kanë bërë të gjithë ekipet e mirëmbajtjes, në mënyrë që të sigurohemi që kjo gjë të mundësohet. Jemi vërtetë krenarë për këtë partneritet dhe për të gjithë këta persona të shkëlqyer që simbolizojnë këtë partneritet", - u shpreh z. Wisner.

Dy helikopterët "Black Hawk" janë porosia e parë e Shqipërisë për këtë model, mbështetur nga fondi i ndihmës së SHBA-së me vlerë mbi 50 milionë dollarë. Helikopterët e rinj do të ndihmojnë në forcimin e aftësive të Forcës Ajrore të Shqipërisë dhe aftësinë për të kryer evakuim mjekësor, rikuperim të personelit, misione kërkim - shpëtimi si dhe mbështetje të lëvizjeve logjistike të NATO-s për operacione dhe stërvitje.

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike nis rrugëtimin e saj në FA

Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, është struktura më e re e ngritur pranë Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me mbështetjen e aleatit tonë strategjik SHBA, ajo është tashmë funksionale.

Në inaugurimin e kësaj njësie morën pjesë Kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i ngarkuari me punë në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë, David Wisner si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Arben Kingji.

Kjo njësi do të luajë një rol kyç në luftën kundër kërcënimeve kibernetike dhe mbrojtjes së sistemeve tona të informacionit.

Të pranishmit u njohën nga afër me strukturën dhe funksionin e kësaj njësie, që ka si qëllim menaxhimin e sistemeve të sigurisë kibernetike që mbikëqyrin dhe monitorojnë: Sistemet e Komunikimit dhe Informacionit të Forcave të Armatosura nga ndërhyrjet e paaautorizuara në këto sisteme.

Pranë kësaj njësie do të jetë i atashuar edhe një këshilltar i huaj, i cili do të mbështesë këtë strukturë për 3 vjet për sigurinë kibernetike.

Në këtë njësi përdoret teknologjia më e fundit, ashtu si edhe në SHBA, ndaj sipas ekspertëve nuk ka patur asnjë rrjedhje informacioni të Ministrisë së Mbrojtjes.

Gjatë fjalës të tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se synimet janë që kjo njësi të shërbejë edhe si një shkollë për të trajnuar ekspertët, jo vetëm për fushën e mbrojtjes, por edhe agjencitë e tjera dhe pse jo edhe tregun privat: “Jo vetëm projekti që është shumë i plotë, por ne kemi mundësinë e madhe që në rrjetin e qendrave të inovacionit të mbrojtjes kiber-



netike të NATO-s të marrim informacione të vazhdueshme, të kemi trajnime. Ka një qendër të NATO-s në Estoni, ku ne jemi pjesë e saj. Mundësitë janë shumë të mëdha. Është arritur brenda një kohe të shkurtër një standard mbrojtjeje shumë i lartë. Janë shumë të motivuar, janë 50% ushtarakë, 50% civilë. Duam ta shtojmë akoma më tej këtë strukturë, ta përdorim si shkollë për të trajnuar ekspertë që mund t'i shërbejnë jo vetëm Forcave të Armatosura, por edhe sektorit privat, sepse në fund të fundit kjo rrit kapacitetet mbrojtëse kom-

bëtare”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi.

Aktualisht, sipas ekspertëve ka çdo ditë 1500 deri në 2 mijë sulme, por asnjë

prej tyre nuk është konsideruar kritik. Në njësinë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, e cila përbëhet nga tre sektorë të veçantë, punohet pa ndërprerje (24/7).



80-vjetori i Çlirimit të Shqipërisë, ngrihet Komision Shtetëror për organizimin e festimeve

Pas mbledhjes së qeverisë, ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi deklaroi për mediat se: “Këshilli i Ministrave ka miratuar projektvendimin për shpalljen e këtij viti 2024, viti mbarëkombëtar i festimeve të 80-vjetorit të Çlirimit të vendit dhe gjithashtu ngritjen e Komisionit Shtetëror për organizimin e festimeve gjithëvjetore për 80-vjetorin e Çlirimit”.

Më tej ministri Peleshi tha se: “Ky komision drejtohet nga Ministri i Mbrojtjes dhe ka në përbërje disa ministra si dhe disa drejtues të institucioneve relevante si Biblioteka Kombëtare, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Instituti i Monumenteve të Kulturës”.

Gjithashtu, shtoi ai, organizatat e veteranëve dhe familjet e dëshmorëve, do të jenë të ftuar dhe pjesë aktive.

“Nuk do të jetë vetëm një ngjarje e datës 29 Nëntor, por do të jetë përgjatë gjithë vitit, jo thjesht dhe vetëm evente festive, por edhe evente shkencore, hulumtime të ndryshme si dhe evente që do të synojnë nxitjen dhe promovimin e dashurisë për Atdheun dhe patriotizmin, sidomos tek brezat e rinj”, - tha ndër të tjera Peleshi.

Shqipëria u çlirua 29 nëntorin e vitit 1944, kur nga Shkodra u larguan nga vendi edhe forcat e fundit të Gjermanisë naziste.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Ushtria Nacional Çlirimtare e Shqipërisë zhvilloi kryengritje të armatosur kundër okupimit të Shqipërisë. Prej 7 prillit të vitit 1939 Shqipëria kishte qenë e pushtuar nga Italia fashiste dhe pas kapitullimit të saj, në vjeshtë të vitit 1943, Shqipëria pushtohet nga forcat gjermane. Në fund të nëntorit 1944, pas Çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor dhe pjesës kryesore të Shqipërisë së Veriut, mbetej të çlirohej qyteti i Shkodrës dhe qarku i tij. Shkodra u çlirua më 29 Nëntor të vitit 1944, datë kjo e cila shënon ditën e çlirimit të Shqipërisë. Shqipëria është vendi i parë në Ballkan që u çliruan me forcat e veta, ndërsa të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit u çliruan me ndihmën e Armatës së Kuqe.



Në mjediset e Flotiljes Detare të Jugut, në Pashaliman, Vlorë u zhvillua ceremonia e nisjes së Kontingjentit III të imbarkuar në anijen “Lissus”, në operacionin e NATO-s, “Sea Guardian”, në Detin Egje.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast ishin të pranishëm komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, kolonel Aleksandër Pando, prefekti i qarkut Vlorë, z. Mamaj, kryetari i Bashkisë Vlorë, z. Dredha, komandantë forcash, drejtorë drejtorish në SHP, familjarë të efektivave, etj.

Fjala e rastit në këtë ceremoni u mbaj nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili ndër të tjera u shpreh: “Sot po zhvillojmë ceremoninë e nisjes së efektivave të Forcës Detare në operacionin ‘Sea Guardian’, në detin Egje. Angazhimet e Forcës Detare jo vetëm në detin Egje por edhe në operacionin FOCOPS, janë një kontribut i rëndësishëm dhe i prekshëm për Aleancën dhe shpreh bindjen se ky kontribut do të vijojë me sukses edhe në të ardhmen, duke shtuar peshën e kontributit të përgjithshëm që vendi ynë jep për Aleancën...”.

Drejtori i SHPFA-së, kolonel Aleksandër Pando, i cili pasi falënderoi të gjithë të pranishmit në ceremoni, u shpreh ndër të tjera: “Në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të

Niset Kontingjenti III në operacionin e NATO-s “Sea Guardian” në detin Egje



Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji, dëshiroj që t’ju përcjell urimet më të mira për të gjithë ju, e në mënyrë të veçantë efektivave të Kontingjentit III pjesëmarrës në operacionin “Sea Guardian” në detin Egje. Sot është një ditë e veçantë për Forcat



e Armatosura, e veçanërisht për Forcën Detare, e cila përcjell në një detyrë shumë të rëndësishme kontingjentin III të imbarkuar në anijen “Lissus” për në zonën e operacionit midis brigjeve turke të Izmirit dhe ishullit grek të Chios...”.

Gjeneralmajor Arben Kingji, mesazh urimi me rastin e 103-vjetorit të krijimit të Armës së Artilerisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, me rastin e 17 janarit, ditës së krijimit të Armës së Artilerisë, ka uruar dhe falënderuar efektivet artiljerë të Forcave të Armatosura, për kontributin e dhënë në rrugëtimin e tyre për më shumë se njëshekullor.

“Të nderuar artiljerë, kam nderin dhe kënaqësinë që t’ju përcjell urimet e mia të përzemërta me rastin e 17 janarit, 103-vjetorit të krijimit të Armës së Artilerisë! Në këtë datë të shënuar, shpreh mirënjohjen dhe respektin ndaj të gjithë artiljerëve që kanë shërbyer dhe shërbejnë në radhët e Forcave të Armatosura. Artiljerët kanë treguar kurdoherë se dinë t’i ruajnë e zhvillojnë traditat e armës, duke qenë në ballë të sfidave dhe të kërkesave të kohës.

Forcat e Armatosura janë duke ndërmarrë projekte ambicioze në drejtim të modernizimit dhe zhvillimit të kapaciteteve të të gjitha armëve dhe shërbimeve. Pjesë e këtyre projekteve është edhe kompletimi i Batalionit të Artilerisë me armatim, teknikë e pajisje bashkëkohore sipas standardeve të NATO-s.

Shpreh bindjen se efektivat e Batalionit të Artilerisë të Forcës Tokësore, si trashëgues të traditave dhe përvojës së gjithanshme të brezave të artiljerëve, do të vijnë në punojnë me përkushtim për të çuar më tej traditën e lavdishme të Armës së Artilerisë.

Gëzuar 103-vjetorin e Armës së Artilerisë!”,
- mbyll urimin e tij gjeneralmajor Arben Kingji.



Kursi XIX Komando realizoi me sukses stërvitjen komplekse 72-orëshe në Feken

Efektivët e Kursit XIX Komando kryen me sukses stërvitjen komplekse në kushte të vështira moti e terreni.

Në këtë stërvitje krahas efektivave tanë morën pjesë dhe efektiva të FSK-së. Kjo stërvitje konsiston në testimin e kapaciteteve dislokuese si dhe testimin e aftësive fizike dhe psikologjike të kursantëve gjatë realizimit të skenarëve stërvitor në kushte të vështira të terrenit e motit dhe përafrimit me situatë reale sipas misionit dhe detyrave që kryejnë efektivet komando të Regjimentit të Operacioneve Speciale.

Kursantët testuan aftësitë psikologjike, fizike dhe operacionale në realizimin e detyrave speciale siç janë: kryerje e marshimit 42 km me pajime e ide taktike, kalimi i vijës së frontit, zënien e rajonit të bazimit, futja në pikën e grumbullimit në objekt, zbulim i fundit në objekt, goditja e objektit, mbijetesa dhe rikthimi në zonën e sigurt.

Gjatë kësaj stërvitjeje efektivet treguan aftësi në realizimin e këtyre detyrave.



Rrugëtimi historik i Armës Xheniere

Ndër shekuj Arma e Xhenios ka udhëtuar duke u transformuar dhe standardizuar si simotrat e saj në të gjitha ushtritë e tjera. Ajo nuk kishte fizionominë, përcaktimin dhe rëndësinë që ka sot, por nuk duhet harruar se ndërtimi i kalave, fortifikatave, tuneleve, kanaleve që shërbenin si pengesa për armikun, urave dhe rrugëve për kalimin e trupave ushtarake, ngritja e kurtheve, hapja e puseve për ujë të pijshëm, përdorimi e pirgjeve të gurëve si mjet luftimi etj., nuk janë asgjë tjetër veçse format e para të Armës të Xhenios, e cila mori trajtat dhe kuptimin e kohës tonë. Natyrisht që ajo do të merrte vlerën e vërtetë fill pas krijimit të ushtrisë tonë, pas shpalljes së pavarësisë, pra, pas 4 dhjetorit të vitit 1912. Dhe ishte 20 janari i vitit 1921, fill pas Kongresit të Lushnjës, kur u vendos krijimi i një kompanie xheniere që quhet dhe data e lindjes së Armës së Xhenios. Çlirimi i vendit nga okupatorët nazifashistë si rezultat i luftës heroike të UNÇ-së krijoi mundësitë që kësaj armë t'i jepej roli dhe vendi i duhur. Këtë e kushtëzonte si nevoja për çminimin e territoreve të mëdha, sidomos përgjatë bregdetit tonë që ishte minuar nga armiku, por edhe perspektiva e modernizimit të ushtrisë për mbrojtjen e vendit. Për këtë shërbyen si oficerët atdhetarë që kishin shërbyer në ushtrinë e vjetër, ashtu edhe kuadrot e dalë nga lufta, shumë prej të cilëve u dërguan për studime të specializuara jashtë vendit e kryesisht në ish-Bashkimin Sovjetik. Me kohë, shumica prej tyre studiuan në shkollat tona si ajo e Bashkuar e Oficerëve e deri në Akademinë Ushtarake. Shumë prej tyre njëkohësisht kryen studimet edhe në universitet ku u titulluan inxhinierë. Këta, kudo që ishin caktuar, nëpër repartet e shumta të shpërndara anë e kënd atdheut, dalloheshin jo vetëm për aftësi të spikatura profesionale e përkushtim, por edhe për kulturë të lartë. Kam pasur fatin t'i njoh nga afër shumë prej tyre dhe ruaj respektin më të madh për kuadrot e kësaj arme. Si mund të harrohet erudicioni dhe humanizmi i Tomor Dedes, takti pedagogjik i Bexhet Guxhollit, urtësia e Stefan Inxhilit, zgjuarsia e Subi Maskës, pedagogëve tanë në shkollën e oficerëve. Puna e ndershme dhe plot sakrificë e përkushtim i sa e sa oficerëve xhenierë nëpër repartet ku punova, më ka mbetur në mendje. E kam ndier atë të Sabri Rexha, që ishte plagosur duke çminuar bregdetin të shkëmbi i Kavajës, ku i ishin vrarë shokë. E kam parë atë të miku im i ndjerë Besnik Alibali, i cili edhe pse i ndëshkuar, dhe i liru padrejtësisht nga ajo çmenduria e politikës, bënte çmos duke organizuar veprimtari nga më të ndryshmet, duke shkruar libra, broshura, fletëpalosje e artikuj nëpër gazeta për të ndërgjegjësuar njerëzit nga rreziku i minave. Si të mos e vija re te puna e të urtit Koli Dano në Durrës e më pas në Korpusin e Tiranës.

Si mund të mos përmendet vepra e inxh. Habil Serjanit në ndërtimin e atyre kthesave të famshme në ata malet shkëmborë pranë Tamarës. Dhe natyrisht, te shoku im i shkollës "Skënderbej" ing. Cane Mehmetaj që punonte si hero për të realizuar detyrat në fortifikim dhe që e ruajti dashurinë për armën e xhenios edhe pasi e dënuan poshtërsisht. Por e ka parë kushdo tek ai xhenieri burrë shteti dhe mjaft i ekuilibruar, Alfred Moisiu, që u bë Ministër i Mbrojtjes e deri President i Republikës në demokraci. Dhe mbi të gjitha, vlerat e tyre janë shkruar me gjakun e mbi 80 dëshmorëve që dhanë jetën në moshën më të re, duke zbatuar detyrat e ngarkuara dhe që në libër është përjetësuar vepra e tyre. Këta që përmenda janë vetëm disa nga ata që e shkuan jetën për ta vënë mbi baza shkencore Armën e Xhenios në Shqipëri, për t'ua mësuar mjeshtërinë dhe sekretet e saj kuadrove, ushtarëve, rezervistëve, studentëve e nxënësve të shkollave,



apo për t'i stërvitur ata sipas kërkesave të Artit Ushtarak të kohës në fortifikimin e vendit. Ndaj u gëzova kur nënkoloneli pasionant Zabit Cuku më solli librin e tij prej 1060 faqesh (vol. I), kushtuar "Oficerëve të Xhenios në rrjedhën e historisë". Parakalojnë aty plot figura të njohura dhe të pa njohura, rreth 500 të tilla, me jetë dhe veprimtari pak a shumë të ndryshme. Të ndryshme në moshë, pjesëmarrje në luftë, shkollim, vendet ku studiuan, repartet ku shërbyen, detyrat që kryen, gradat e dekoratat që fituan, fatet politike që i ndoqën etj. por sa të ngjashëm në atdhetari, ndershmëri, përkushtim, dashuri për profesionin, solidaritet e deri korrektesë shembullore si bashkëshortë apo si prindër. Kam ndeshur aty shumë nga shokët e mi të shkollës së mesme ushtarake "Skënderbej", si Canja, Andon Dhana, Hiqmet Muça, Riza Murati, Teodor Biceri, Ilirian Xhemalaj, Skënder



Sulaj etj., dhe janë përshkruar nga ky autor me shumë vërtetësi. Ata ishin djem nga më të mirët dhe të tillë mbetën derisa dolën në pension. Duke iu përmbytur një metodologjie skrupuloze, Zabit Çuku ka arritur të japë vazhdimësinë e funksionimit të kësaj arme, pra traditën që krijuan aty kuadrot me emër në ushtri, si (veç disave që përmenda deri tani), Veli Dedi, Dhimitër Dhespoti, Spiro Shalsi, Menduh Backa, Josif Zegali, Abedin Poloska, Petrit Çobani, Pandi Dushku, Kadri Brahimaj, Njazi Çepani, Myfit Mushi, Maliq Tartari me shokë. Nga kjo armë, ushtrisë shqiptare iu shtuan

major Klodian Tanushi, nëntetare Zarife Hasanaj, e rreshter Julian Kapaj, që dhanë jetën në Letoni. I lexon emrat dhe veprën e tyre dhe ndien nderim e krenari për bij të tillë të atdheut tonë. Dhe këtë nderim e krenari e ndien për armatën e xhenierëve që ndër dekada kryen punime të jashtëzakonshme, sidomos vendkomanda, spitale e vendstrehime njerëzish, armatimesh e municionesh.

Janë mbresëlënëse ato të bazave të FLD-së apo aviacionit të asaj kohe si p.sh. ajo në Gjadër, i cili pas viteve 1990 u vizitua nga ushtarakë të lartë të vendeve anëtare të NATO-s, mes tyre Shefi i



shumë oficerë madhorë si dhjetëra kolonellë dhe gjeneralë si Luan Hoxha dhe zoti Dedë Prenga.

Shumë prej tyre janë dalluar edhe si personalitete të kulturës tonë, si fjala vjen shkrimtari i njohur Vasil Premçi apo ish-komandanti i Brigadës së Urave në Kavajë, i ndjeri Mustafa Dervishi, autor i disa romaneve mjaft të arrira, por që Kovidit e ndau nga jeta. Po kështu kujtojmë ata që shkuan nëpër misione jashtë vendit si kapiten Feti Vogli, rënë në Afganistan,

Shtabit të Turqisë bërë vlerësimin e kuadrove që kanë ndërtuar këto objekte me vlera të rralla ndërtuese dhe historike në rajon e më gjerë. Dhe të mendosh se aso kohe teknika që përdorej nuk ishte e avancuar si kjo e tashmja. Por kuadrot e xhenios e efektivat e tyre, punonin me shpirt e sedër të madhe.

*"Historia e Armës së Xhenios në Shqipëri",
Zabit Cuku*



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

“Lufta, virus ende pa vaksinë, të përpiqemi për ta shëruar botën”

Teksa përpiqemi të bëjmë analiza si qenie humane mbi realitetin e sotëm, mbi atë se çfarë po ndodh në gjithë globin, ku çdo cep i saj ‘kundërmon’ era barut, ku qiejt ‘oshtijnë’ prej avionëve ‘përbindështa’ dhe ku rrugët janë ‘pikturuar’ dhimbshëm prej rrekesh gjaku. Të duket se ky fenomen me termin Luftë, nuk paska pasur një fund, ajo ka qenë aty, gëlonte deri sa çdo ditë shpërthen gjithandej si krater vullkani. Por sot luftërat çuditërisht kanë një konotacion tjetër, “Luftëra Moderne”, ku me një tastierë kompjuteri përpara dhe një ‘klik’ mbi të, bën që me mijëra kilometra katrorë tokë të mos mbijë për qindra vjet qoftë dhe një lule e jo më jetë njerëzore. Shpesh në kontradiktë me veten time, analizoj jo fenomenin por shkaktarin e tij, humanët, psikologjinë, çfarë e bën racën njerëzore të urrejë llojin e vet? Pse ‘grykësia’ është kthyer në ‘pasion’?

Luftërat i fitojnë njerëzit dhe jo armët

Lufta është ferri në Tokë, dhe nëse dyshoni për këtë vizitoni tani Ukrainën. Sigurisht edhe një luftë e vogël është e tmerrshme për ata që janë të përfshirë në të.

Ndaluni një moment dhe reflektoni mbi pasojat. Lufta është rikthyer. Por a mund të rikthehet edhe lufta botërore?

Nëse po, ajo do të ndikojë në të gjithë jetën tonë. Në epokën e dytë midis 2 luftërave (1991-2019), ne e harruam rolin e luftës mbi ekonominë globale. Për shkak se luftërat e asaj kohe ishin të vogla (Bosnje, Afganistan, Irak), harruam se lufta është shtytësi i preferuar i historisë për inflacionin, falimentimin për shkak të borxheve, por edhe për zininë e bukës. Kjo sepse lufta në shkallë të gjerë, është njëkohësisht shkatërruese e kapaciteteve prodhuese, përçarëse e tregtisë dhe destabilizuese e politikave fiskale dhe monetare. Por ajo ka të bëjë po aq edhe me mobilizimin e burimeve reale sa edhe me financat dhe paratë: çdo fuqi e madhe duhet të jetë në gjendje të ushqejë popullsinë dhe të fuqizojë industrinë e saj.

Bota apo Lufta? Kush krijoi, kë?

Në të gjithë botën ka pasur luftëra që nga kohërat e lashta gjatë gjithë historisë, madje edhe kur është e qartë se luftërat shkaktojnë shkatërrime të jetës dhe pronës së njerëzve, ende justifikohen dhe shihen si zgjidhje e fundit për shumë probleme.

Shpeshherë, lufta çuditërisht ka shërbyer si një forcë kryesore lëvizëse, që ka kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të komuniteteve dhe shfaqjen e mundësive të reja. Ajo është konsideruar si një nga mjetet e seleksionimit natyror që ka nxitur mbijetesën e grupeve më të forta dhe zhdukjen e atyre më të dobëta.

Cilat kanë qenë shkaqet e luftërave?

Shkaqet e luftërave kanë qenë të ndryshme përgjatë historisë. Në përpjekje për të marrë një avantazh të caktuar konkurrues, shtetet kanë luftuar për territor, burime, njerëz dhe dominim të natyrave të ndryshme. Megjithatë, në rrjedhën e evolucionit të shoqërisë dhe zhvillimit të diplomacisë, shkaqet e luftës tanimë janë më komplekse. Rasti i konfliktit të tanishëm Rusi-Ukrainë provon se nuk janë të rralla rastet kur një shtet sulmon shtetin sovran fqinj, duke u thirrur



në mbrojtjen e pakicave të veta atje, që luajnë rolin separatist dhe të viktimës në këto raste, duke i dhënë shkas të mjaftueshëm shtetit amë për invazion të armatosur, e që në fakt shpesh është një pasqyrë e situatës në terren.

Në rastin e tanishëm të Ukrainës është edhe

përsëritje e historisë: më 17 shtator 1939, Ministria Sovjetike e Punëve të Jashtme dërgoi një notë që t’i jepej urdhër trupave sovjetike për të mbrojtur popullsinë ukrainase e bjelloruse që jetonin në Poloni. Në këtë mënyrë, kompleksiteti i ngjarjeve të sotme të luftës në Ukrainë krijon rrezik për

zgjerrim të luftës së armatosur ndërmjet më shumë vendeve evropiane.

Shumë kultura moderne zakonisht janë të prirura t’i konsiderojnë luftërat si veprim dinjitoz, edhe pse ato rezultojnë me shumë vdekje ose vuajtje të qenieve njerëzore. Kjo vjen pjesërisht nga fakti se lufta konsiderohet si një shenjë respekti dhe pjesërisht sepse pjesëmarrja në luftëra në shumë kultura është shenjë krenarie dhe guximi, në përpjekje për t’i shërbyer vendit duke e mbrojtur atë!

Çfarë është lufta?

Lufta shkatërron familjet dhe asgjëson vlerat më të çmueshme njerëzore. Njerëzit që kanë përjetuar luftën shumë shpesh nuk janë në gjendje të rivendosin ekuilibrin e tyre të brendshëm dhe të ribashkohen me familjen për shkak të dallimeve në qëndrimet ndaj luftës dhe qasjes së shoqërisë ndaj tyre, kështu që shpesh rezulton me kolapsin e sistemit tradicional të vlerave.

Në përgjithësi, vetë natyra e luftës dhe karakteri i saj kanë një ndikim shkatërrues në jetën e njerëzve. Pavarësisht se lufta mund të shkaktojë dëme dhe tortura të mëdha në jetën e njerëzve të përfshirë në të, në varësi të situatës ajo është edhe e justifikueshme. Për shembull, nëse shteti përfshihet në luftë si një mënyrë vetëmbrojtjeje nga shfarosja apo deportimi, atëherë ajo është e justifikueshme, siç ishte lufta çlirimtare e UÇK-së 1998-1999, që u përkrah nga shumica e botës demokratike.

Lufta ka fytyrën e tmerrit, shkatërrimit dhe shpërfaq mizorinë e njeriut ndaj njeriut në formën më të tmerrshme.

prandaj STOP LUFTËS!





Duket çmenduri të diskutosh mbi koston financiare të një lufte kur në lojë janë jetët e miliona njerëzve, dhe natyrisht që ne do të donim të reduktonin humbjet e jetëve, që janë tragjedia e vërtetë e çdo lufte. Por ja cilat janë deri më sot 10 luftërat më të kushtueshme në histori.

Lufta e Dytë Kinë-Japoni: 1.3 miliardë dollarë në muaj sipas kursit aktual

Shumica e luftërave më të kushtueshme në histori kanë përfshirë Shtetet e Bashkuara, por jo të gjitha. Një nga luftërat më të mëdha moderne ishte Lufta e Dytë Kinë-Japoni, e cila u zhvillua në vitet 1937-1945, pra në pjesën më të madhe të kohës përkon me Luftën e Dytë Botërore.

Ajo ishte pjesë e asaj që e bëri në thelb Luftën e Dytë Botërore një luftë të vërtetë botërore, por që shpesh lihet jashtë librave të historisë perëndimore, sepse nuk përfshiu drejtpërdrejt Forcat Aleate. Lufta Kinë-Japoni u zhvillua kryesisht midis këtyre 2 vendeve fqinje. Në kulmin e luftës, Japonia shpenzonte rreth 7.713.150 jen në muaj.

E përshtatur me inflacionin dhe e konvertuar në dollarë, kostoja përfundimtare është diku midis 413 milionë dhe 1.3 miliardë dollarëve në muaj. Arsyeja pse ky diapazon është kaq i madh, është se gjetja e një metode për llogaritjen e inflacionit të jenit në kohën e Luftës së Dytë Botërore është pothuajse jo-ekzistente.

Nëse e konvertoni jenin në dollarë dhe më pas e përshtatni me inflacionin, atëherë kemi shifrën 1.3 miliardë dollarë. Dhe nëse kemi parasysh që lufta zgjati 8 vjet, atëherë kjo do të thotë se Japonia shpenzoi në atë luftë mbi 39 miliardë dollarë, ose maksimumi mbi 100 miliardë dollarë. Dhe këtu nuk llogariten kostot që solli ajo luftë për Kinën.

Lufta Civile Amerikane: 87 miliardë dollarë sipas kursit të sotëm

Në kohën kur filloi Lufta Civile, SHBA ishte e zhytur në borxhe. Nga shuma modeste prej 64.8 milionë dollarësh në vitin 1861, borxhi arriti deri në fund të luftës në mbi 5.2 miliardë dollarë. Dhe e përshtatur me inflacionin kjo shumë ishte rreth 87 miliardë dollarë. Qeveria miratoi në vitin 1862 Aktin e Tenderit të Ligjshëm për të ndihmuar në financimin e luftës. Kjo përfshinte shitjen e 500 milionë dollarëve në obligacione, por edhe prodhimin e parave prej letre në formën e dollarit. Ato ishin kartëmonedhat e para, vlera e të cilave nuk ishin e mbështetur tek ari.

Në thelb, ato ishin thjesht letra me vlerë të lëshuara nga qeveria, dhe qytetarët mund të paguanin me to për çdo gjë, nga sendet ushqimore tek taksat. Llogaritje të tjera përcaktojnë se kostoja e asaj lufte ishte rreth 7 miliardë dollarë. Sipas këtyre shifrave, veriu shpenzoi rreth 139 dollarë për frymë, shumë që ishte pak më e vogël sesa PBB-ja vjetore për frymë. Në jug, kostoja ishte rreth trefishi i kësaj shifre.

Lufta e Koresë: 308 miliardë dollarë

Ajo mund të ketë qenë burimi i komedisë së famshme “M*A*S*H” në SHBA. Por kostoja e Luftës së Koresë nuk ishte aspak një shaka. Kur përfundoi në vitin 1953, kostoja totale u llogarit në rreth 30 miliardë dollarë.

Por e përshtatur me inflacionin, kjo arrin në mbi 308 miliardë dollarë. Në 3 vite humbën jetën mbi 36 mijë amerikanë, mbi 1 milionë civilë të Koresë së Jugut dhe 200.000 civilë në Korenë e Veriut.

Lufta e Vietnamit: 1 trilion dollarë

Edhe pse filloi zyrtarisht në vitin 1959, SHBA-ja u përfshi në Luftën e Vietnamit vetëm në vitin 1965, dhe qëndroi atje deri në vitin 1973. Gjatë atyre 8 viteve, u shpenzuan mbi 168 miliardë dollarë, përfshirë 28.5 miliardë dollarë që iu dhanë si ndihmë popullit të Vietnamit të Jugut.

Nëse përshtatet me inflacionin aktual, kjo shumë arrin në mbi 1 trilion dollarë. Disa studiues flasin për një kosto prej 1.25 trilionë dollarësh. Gjithsesi kjo çështje është ende objekt i debateve të forta, pasi shpenzimet për të po vazhdojnë edhe sot e kësaj dite.

Kjo pasi veteranët e asaj lufte dhe familjet e tyre, po kompensohen me një normë vjetore prej 22 miliardë dollarësh. Që nga viti 1970, përfitimet e tyre kanë arritur në rreth 270 miliardë dollarë. Veteranët e Vietnamit kanë të drejtën e përfitimeve, madje edhe bashkëshortet e tyre, në rast se partneri i tyre vdiste për shkaqe të lidhura me luftën.

Edhe fëmijët e ushtarakëve morën përfitime financiare deri sa arritën në moshë madhore. Për shkak të problemeve që lidhen me Sindromën e Stresit Post-Traumatik (PTSD), diçka që nuk u trajtua para Vietnamit, si dhe ekspozimit ndaj agentëve kimikë “Orange” dhe një sërë sëmundjesh të tjera, qeveria do të vazhdojë të paguajë veteranët që janë ende gjallë edhe për disa vite të tjera.

Lufta e Irakut: 1.9 trilionë dollarë

SHBA-ja u përfshi në Luftën e Irakut gjatë viteve 2003-

Luftërat që ndryshuan botën



2011. Trupat kanë qëndruar në atë vend pothuajse pa pushim, që nga i ashtuquajtimi i luftës. Kostoja totale e saj është llogaritur në 1.9 trilionë dollarë. Kjo shifër mbulon një gamë të gjerë shpenzimesh. Ngjashëm me shumicën e luftërave të tjera, pjesa më e madhe i takon shpenzimeve të përditshme të luftës.

Pra mbi ushtarët në terren dhe pajisjet që përdorin ata. Por shumë nga ato para u vodhën.

Paratë e dhëna kontraktorëve privatë u përvetësuan si në Irak po ashtu edhe në Afganistan.

Në fakt, vlerësohet se rreth 1/3 e parave që u jepen kompanive private shpenzohen për operacione fiktive.

Shumë shpesh kontraktorët e mbi-faturojnë qeverinë për të mbushur xhepat e tyre. Në luftërat në Irak dhe Afganistan, ky abuzim ka arritur në 31-60 miliardë dollarë. Një total prej mbi 138 miliardë dollarësh shkuan për kontraktorët privatë.

Lufta në Afganistan: 2.3 trilionë dollarë

Ajo e Afganistanit, është një nga ato luftëra që duket sikur ka vazhduar gjithmonë. A ka përfunduar zyrtarisht tani? Ndoshta. Por ajo zgjati për më shumë se 2 dekada dhe rajoni nuk është aspak i qëndrueshëm, ndaj nuk është ende koha që të shpallet përfundimi i misionit.

Por edhe në këto kushte, çmimi i paguar për çdo gjë që është arritur është tepër i madh. Shifrat ndryshojnë herë pas here, por konsensusi i përgjithshëm është se kostoja në total ka qenë rreth 2.3 trilionë dollarë. Një total prej 800 miliardë dollarësh shkuan për shpenzime direkte, si pagat për ushtarët dhe pajisjet.

85 miliardë dollarë të tjerë u shpenzuan për të trajnuar ushtrinë afgane. Edhe pse Talebanët e ripushtuan vendin dhe e mposhtën brenda disa ditësh. 750 milionë dollarë të tjera shkuan për pagimin e pagave për ushtrinë afgane. Kostot e tjera përfshijnë paratë e shpenzuara për të ndihmuar veteranët e plagosur, si dhe interesin e humbur të gjithë parave të shpenzuara.

Lufta e vitit 1812: 2.8 trilionë dollarë me kursin e sotëm

Një nga luftërat më të hershme në historinë e SHBA-së, Lufta e vitit 1812 u dëshmuar të ishte një katastrofë financiare për epokën, dhe u deshën gati 20 vjet që të shlyhej ai borxh. Në fundin e asaj lufte, qeveria kishte në arkë vetëm 158 milionë dollarë. Mbi 90 milionë dollarë shkuan për të paguar ushtrinë dhe marinën.

Të përshtatura sipas inflacionit, kjo shumë shkon në total rreth 2.8 trilionë dollarë. Ndërkohë në vitin 1814, qeveria amerikane ishte praktikisht e falimentuar. Ajo kishte marrë shumë kredi dhe ishte e paaftë të bënte shpenzimet e zakonshme. Pagat për ushtarët u vonuan me gati një vit.

Qeveria amerikane u detyrua t’u ofronte ushtarëve tokë në këmbim të shërbimit, duke premtuar deri në 320 hektarë për çdo ushtar që luftonte deri në fund të luftës, pavarësisht mungesës së çeçeve. Në fakt ishin milionerët e famshëm, ata që paguan një pjesë të madhe të borxhit që qeveria kishte shkaktuar gjatë rrjedhës së luftës. Vetëm Dejvid Parish, Stefën Xhirard dhe Xhon Astor shpenzuan afro 16 milionë dollarë për të ndihmuar vendin. Kjo shumë është e barabartë rreth 250 milionë dollarë me kursin e sotëm.

Lufta e Parë Botërore: 3.3 trilionë dollarë me kursin e sotëm

Në atë kohë, kostoja e luftës ishte diku midis 185 dhe 208 miliardëve dollarë, në varësi të burimeve që mund t’i referoheni. Por edhe nëse shkoni në nivelin e ulët të kësaj shkalle dhe llogaritni inflacionin që nga viti 1918, do të mbërrini në shumë astronomike prej 3.3 trilionë dollarësh.

Gjermania harxhoi më shumë para sesa çdo vend tjetër, gjë që është e kuptueshme. Totali i shpenzimeve të tyre në dollarë gjatë luftës ishte mbi 37 miliardë dollarë, ose rreth 686 miliardë dollarë me kursin e sotëm. SHBA-ja harxhoi 414 miliardë dollarë, ndërsa britanikët mbi 641 miliardë dollarë.

S’ka nevojë të thuhet, se kur bëhej fjalë për financat, atë luftë nuk e fitoi askush. Efekti i saj në ekonominë gjermane ishte shumë i rëndë. Disa pjesë të Gjermanisë përjetuan një hiperinflacion të paimagjinueshëm. Një copë buke kushtonte 428 miliardë marka gjermane. Markat vlenin më pak se sa letra në të cilën ishin shtypur.

Një dollar amerikan këmbehej me 4.210.500.000.000 marka, ose 4.2 trilionë. Pra për ta financuar atë luftë gjermanët shkatërruan ekonominë e tyre. Kriza e rëndë ekonomike që pasoi, ishte pjesërisht arsyeja që i hapi rrugën ngjitjes në pushtet të Adolf Hitlerit.

Lufta e Dytë Botërore: 4.7 trilionë dollarë me kursin e sotëm

E përshtatur me inflacionin, supozohet se Lufta e Dytë Botërore kushtoi mbi 4.7 trilionë dollarë. Në vitin e fundit të luftës, paratë e shpenzuara ishin sa 40 për qind e PBB-së totale të Shteteve të Bashkuara. Krahastuar me sot, kjo është shumë më tepër sesa shpenzojmë për luftërat moderne, të cilat janë gjithsesi në nivelet e trilionit dollarëve.

Një pjesë e këtyre shpenzimeve vjen nga shkalla e gjerë e angazhimit gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ushtria amerikane mund të ketë 2.5 milionë pjesëtarë në krahasim me Luftën e Parë Botërore, kur ishin rreth 12.2 milionë. Këto para shkuan për gjëra të tilla si 41 miliardë fishekë, 303.000 avionë, 100.000 tanke dhe 27 aeroplanmbajtëse, mes shumë shpenzimeve të tjera.

Për të ndihmuar në mbulimin e kostos, taksat u rritën në disa raste deri në 94 për qind. Për të garantuar qëndrimin e trupave në kazerma, ushtarët paguheshin 50 dollarë në muaj. Kjo shumë është sot e papërfillshme, por në ato kohë ajo rrogë ishte më e madhe sesa marrin sot shumica e profesionistëve.

Lufta e Ftohtë: 10 trilionë dollarë

Teknikisht, Lufta e Dytë Botërore është lufta më e shtrenjtë e zhvilluar ndonjëherë. Por Lufta e Ftohtë konsiderohet ende si një luftë, edhe nëse trupat nuk kryen pushtime të mëdha. Duke u shtrirë nga viti 1940 dhe deri në vitin 1996, nëse llogaritet sesa para u shpenzuan në garën e armëve bërthamore që ishte në thelbin e konfliktit të Luftës së Ftohtë, vetëm Amerika humbi 5.8 trilionë dollarë.

Ju mund të supozoni me të drejtë se edhe qeveria sovjetike shpenzoi shuma të mëdha, pavarësisht nga fakti se të dhënat e tyre janë vështirësisht të besueshme. Është ndoshta një bast i sigurt të hamendësohet se mbi 10 trilionë dollarë u shpenzuan në mbarë botën për Luftën e Ftohtë, dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të arsenaleve bërthamore.

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në Takimin Vjetor të Forumit Ekonomik Botëror në Davos, Zvicër, më 16 janar 2024, ku nënvizoi rëndësinë e mbështetjes së vazhdueshme për Ukrainën.

Ndërsa pranoi se situata në fushën e betejës është jashtëzakonisht e vështirë, me rusët tani, duke shtyrë në shumë vija të frontit, Stoltenberg nënvizoi se ka gjithashtu arsye për optimizëm. Ai vuri në dukje arritjet mbresëlënëse të Ukrainës në çlirimin e territorit, hapjen e korridorit për eksportin e grurit në Detin e Zi dhe në përgjithësi mbijetesën e Ukrainës si një komb sovran dhe i pavarur.

Nga ana tjetër, ai tha se Rusia ka humbur atë që donte të arrinte me luftën, që ishte, të kontrollonte Ukrainën. Ukrainasit tani janë të orientuar fort drejt Perëndimit, duke aspiruar anëtarësimin në NATO dhe Bashkimin Evropian dhe, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se “mbështetja për Ukrainën nuk është bamirësi, është një investim në sigurinë tonë”.

Duke vënë në dukje natyrën gjithnjë e më globale të sigurisë, Stoltenberg vuri në dukje se partnerët e ngushtë të NATO-s, Japonia dhe Koreja e Jugut, janë gjithashtu të shqetësuar për luftën e Rusisë kundër Ukrainës, pasi një fitore e Presidentit Putin do të rriste gjasat që Pekini të përdorte forcë diku tjetër.

Sekretari i Përgjithshëm ishte pjesëmarrës në panelin “Sigurimi i një bote të pasigurt” së bashku me ministren e Jashtme finlandeze Elina Valtonen, ministren e Jashtme gjermane Annalena Baerbock, ministrin e Jashtëm nigerian Yusuf Tuggar, ministrin e Jashtëm saudit Princi Faisal bin Farhan Al Saud dhe senatorin amerikan Chris Coons. Diskutimi u moderua nga Presidenti i Forumit Ekonomik Botëror, Borge Brende.

Sekretari i Përgjithshëm mori pjesë gjithashtu në një dialog midis liderëve politikë, CEO-ve dhe zyrtarëve të tjerë për të diskutuar rolin e sektorit global privat dhe publik në rindërtimin afatgjatë të Ukrainës, së bashku me Presidentin Volodymyr Zelenskyy dhe Presidenten e Komisionit Evropian Ursula von der Leyen.

Ndërsa ishte në Davos, Sekretari i Përgjithshëm foli gjithashtu edhe në një sesion me dyer të mbyllura të Këshillit Ndërkombëtar të Biznesit. Ai zhvilloi gjithashtu takime me një numër liderësh botërorë, përfshirë presidentin Zelenskyy, presidentin polak Andrzej Duda, presidenten zvicerane Viola Amherd dhe kryeministrin irakian Mohammed Shia Al-Sudani.

Ukraina më afër NATO-s dhe BE-së, se kurrë më parë

“Për shkak të situatës aktuale, realitetit në Ukrainë, sigurisht ka arsye për t’u shqetësuar, pasi Ofensiva e madhe e Pranverës nuk dha rezultatet që të gjithë shpresonim”, - tha në fjalën e tij Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në panelin “CEO’s for Ukraine” në Forumin Ekonomik Botëror. “Këtë verë, ne shohim se si Rusia nisi sulme të reja ndaj Ukrainës, ne shohim se si Rusia po merr më shumë armë, po blen dronë nga Irani, raketa nga Koreja e Veriut dhe se si ata po ndërtojnë forcat e tyre ushtarake. Pra, situata në terren në Ukrainë është sfiduese, është në vështirësi, është e vështirë”, - tha Stoltenberg, - por pavarësisht këtyre vështirësive, ka arsye për optimizëm”, - tha ai duke ndarë shkurtimisht me të pranishmit situatën në Ukrainë.

“Së pari, duhet të mbani mend se nga filluam, kur filloi kjo luftë, shumica e ekspertëve edhe në kryeqytetet tona, besuan se Kiev do të binte brenda disa ditësh dhe Ukraina brenda javësh, kjo nuk ndodhi, për shkak të guximit, për shkak të vendosmërisë së Udhëheqja ukrainase, e popullit ukrainas. Por, sigurisht, edhe për shkak të mbështetjes nga aleatët e NATO-s”, - tha Stoltenberg.

Ukrainasit kanë mundur të çlirojnë 50% të territorit që Rusia pushtoi në fillim të luftës, ata kanë hapur një korridor në Detin e Zi, në gjendje të eksportojnë drithëra dhe mallra të tjera dhe ata rrëzuan një avion të avancuar më 15 janar 2024. “Pra, ata kanë aftësi, ata kanë dëshmuar aftësitë për t’i përdorur ato aftësi. Dhe kjo është një fitore e madhe për Ukrainën. Ndoshta fitorja më e madhe është se Ukraina ka mbijetuar si një komb i pavarur sovran demokratik në Evropë, një fitore e madhe për Ukrainën dhe një humbje e madhe për Rusinë”, - tha Shefi i NATO-s. Ndërkohë Presidenti Putin nuk e ka arritur atë që synonte, dhe kjo ishte për të kontrolluar Ukrainën, ai nuk e kontrollon Ukrainën, ai ka paguar një çmim të madh, ka humbur 300,000 ushtarë, viktima, mijëra automjete të blinduara, qindra avionë. Por më e rëndësishmja, ai e ka humbur mundësinë për të kontrolluar ndonjëherë Ukrainën, sepse populli ukrainas është larguar nga Rusia. Ata duan t’i bashkohen Evropës, BE-së, NATO-s.

Sekretari i Përgjithshëm theksoi se Ukraina tani është më afër NATO-s dhe BE-së se kurrë më parë, dhe se ata bëhen anëtare të NATO-s anëtare të BE-së. “Kjo është fitorja e madhe për ne, përgjegjësitë tona që na duhen, natyrisht, për të vazhduar dërgimin e armëve”, - tha ai.

Duke e nënvizuar këtë si “një përgjegjësi si udhëheqës politikë, por edhe si CEO, si njerëz të biznesit dhe qytetarë të vendeve për të

Forumi Ekonomik Botëror në Davos, Stoltenberg: Mbështetja për Ukrainën nuk është bamirësi, është investimi në sigurinë tonë



siguruar që vullneti politik të mbetet në vendet tona për të mbështetur mbështetjen për Ukrainën” Stoltenberg u shpreh se: “Nuk na lejonet të themi se jemi të lodhur, sepse paguajmë një çmim të cilin e matim me krona, dollarë dhe euro, ndërsa ukrainasit, paguajnë një çmim

të matur me jetë të humbura. Kjo nuk është bamirësi. Ky është interesi ynë i sigurisë për të investuar në mbrojtjen e Ukrainës”. Duke përfunduar Stoltenberg tha se është optimist, “por ne kemi nevojë që të gjithë të mobilizohen dhe të mbështesin Ukrainën”.

Forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s: Shefat e Mbrojtjes të Aleancës takohen me Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s

Autoriteti më i lartë Ushtarak i NATO-s, Komiteti Ushtarak, më 17 dhe 18 janar 2024, u takua në formatin e shefave të Mbrojtjes në selinë e NATO-s në Bruksel. Në takimin e ditës së parë, më 17 janar takimi u zhvillua me pjesëmarrjen edhe të Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Mircea Geoană. Fokusi i takimit ishte forcimi i parandalimit dhe mbrojtjes së NATO-s duke maksimizuar ekzekutueshmërinë e planeve të reja të mbrojtjes. Në fjalën e tij të hapjes, Admirali Rob Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak theksoi se “Pllakat tektonike të fuqisë po ndryshojnë. Si rezultat, ne përballemi me botën më të rrezikshme në dekada. NATO ka hyrë në një epokë të re të mbrojtjes kolektive. Së bashku ne po mbrojmë shumë më tepër se sigurinë fizike të 1 miliard njerëzve tanë dhe 31 (së shpejti 32) kombe. Ne po mbrojmë lirinë dhe demokracinë”, - tha ai. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm falënderoi në emër të Aleancës Shefat e Mbrojtjes për përkushtimin dhe punën e tyre të palodhur. “Ju keni bërë shumë për të garantuar sigurinë e Aleancës sonë, më shumë sesa të gjithë paraardhësit tuaj. Kështu që unë dua të filloj duke ju falënderuar të gjithëve për punën e pabesueshme që ju burrat dhe gratë me uniformë keni bërë, po bëni dhe do të vazhdoni të bëni për sigurinë tonë, për kombet tona dhe në të vërtetë CMC, për të mbrojtur sigurinë tonë.” Admirali Bauer vlerësoi strukturën politiko-ushtarake të NATO-s dhe përshëndeti angazhimin e vazhdueshëm të z. Mircea Geoana me udhëheqjen ushtarake. “Është puna jonë së bashku që ne sigurohemi që vullneti politik të përputhet me aftësitë ushtarake. Është dëshmi e natyrës unike të Aleancës sonë politiko-ushtarake”.

Gjatë fjalëve të tij, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoana përshkroi disa nga prioritetet kryesore për Samitin e Uashington DC në korrik 2024. “Në samitin e këtij viti në Uashington, ne do të shkojmë më tej. Duke bërë atë që është e nevojshme për të garantuar sigurinë e popullit tonë, të kombeve tona dhe po, të sistemit të bazuar në rregulla ndërkombëtare. Ne do të forcojmë mbrojtjen tonë kolektive, veçanërisht mbrojtjen tonë ajrore dhe rakitore. Ne do të rrisim mbështetjen tonë për Ukrainën. Dhe unë jam mirënjohës për të gjithë ju që u takuat me homologun

tuaj ukrainas sot. Takimi i parë i formatit të Këshillit të Shefave të Mbrojtjes NATO-Ukrainë është një tjetër dëshmi e mbështetjes sonë të qëndrueshme për këtë komb. Ne do të punojmë edhe më ngushtë me partnerët tanë në mbarë botën. Faleminderit përsëri për takimin me partnerët tanë. NATO mund të jetë një aleancë rajonale dhe kjo nuk do të ndryshojë. Por ne përballemi me sfida globale dhe duhet të angazhohemi edhe më shumë”, tha z. Geoana. Duke diskutuar planet e reja të mbrojtjes, Admirali Bauer tha se “këto janë planet më gjithëpërfshirëse të mbrojtjes që NATO ka pasur që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Asnjëherë më parë planet e NATO-s dhe të mbrojtjes kombëtare nuk kanë qenë të ndërlidhura kaq ngushtë”, dhe nënvizoi rëndësinë e planeve të reja të mbrojtjes dhe se si ato do të formësojnë forcat e armatosura aleate për dekadat e ardhshme.

Admirali Bauer theksoi më tej se si aleatët po punojnë tani në mënyrë aktive për të maksimizuar ekzekutimin e planeve të reja të mbrojtjes. Nga ana ushtarake ka më shumë hapa që duhen ndërmarrë për të arritur atje ku NATO dëshiron të jetë për mbrojtjen e saj kolektive. Duke vënë në dukje rëndësinë e transformimit të luftimeve të NATO-s, Admirali Bauer foli për nevojën për t’u fokusuar në efektivitetin në vend të efikasitetit në këtë epokë të re të mbrojtjes kolektive. Në pritje të konferencës së gjeneralit Valerii Zaluzhnyi, shefit të Mbrojtjes së Ukrainës për situatën në Ukrainë, Kryetari i Komitetit Ushtarak përcaktoi se “Ukraina do të ketë mbështetjen tonë për çdo ditë që do të vijë”, dhe se “rezultati i kësaj lufte do të përcaktojë fatin e botës”. Në përfundim të fjalës së tij të hapjes, Admirali Bauer u ndal në bashkëpunimin e NATO-s me Partnerët. Në një botë më të rrezikshme, bashkëpunimi i ngushtë dhe ndërveprueshmëria e shtuar është parësore. Ekziston një nevojë e shtuar për t’u përgatitur për të papriturat dhe për të parë sfidat nga të gjitha perspektivat e kërcënimit, “për këtë, bashkëpunimi ynë me Partnerët është kyç”, - theksoi Admirali Bauer. Pas përfundimit të takimit të ditës së dytë, më 18 janar 2024, Admiral Bauer, Komandanti Suprem i Aleatëve për Evropë, Gjeneral Cavoli dhe Zëvendës Komandanti Suprem i Aleatëve për Transformimin Gjeneral Badia, mbajtën një konferencë e përbashkët për shtyp.

111 vjet Polici Shqiptare



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Me rastin e 111-vjetorit të krijimit të Policisë së Shtetit shqiptar 13.1.1913–13.1.2024; rrugëtim i mundimshëm dhe plot sakrificë i institucionit që garanton sigurinë publike të shtetit shqiptar. Pavarësia e Shqipërisë, zgjedhja e organeve ekzekutive e legjislativë të shtetit më 1912-ën ishin aktet sublime dhe domosdoshmëri jetike në krahurën ballkanike e europiane të fillim-shekullit XX. Kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali njoftoi gjashtë Fuqitë e Mëdha: Anglinë, Italinë, Austro-Hungarinë, Francën, Gjermaninë dhe Rusinë, për këtë akt madhor dhe vendimtar të shqiptarëve. Shqiptarët njoftuan edhe shtetet ballkanike si: Rumani, Mali i Zi, Serbi, Bullgari, Greqi e Turqi, duke iu kërkuar njohjen e pavarësisë, që ishte vullneti unanimit të shqiptarëve. Më 28 Nëntor 1912, Ismail Qemali u shpall kryetar i Kuvendit dhe kryetar i parë i qeverisë së shtetit shqiptar. Pavarësia u shpall për të gjitha trojet shqiptare. Ministrat u përzgjedhën nga të gjitha trevat shqiptare. Pavarësia përbënte aktin madhor dhe ngjarje kulmore në historinë e shqiptarëve, fryt i përpjekjeve dhe i luftërave shekullore të gjithë shqiptarëve, për tërësinë tokësore dhe krijimin e shtetit të pavarur. Me vendimin e Kuvendit të Vlorës, kombi shqiptar fitoi të drejtën e tij të pamohueshme për të qenë i lirë e i pavarur, krahas kombeve e popujve të tjerë të Evropës. Vetëm një javë më vonë u formatua qeveria, ndërkohë që nevojë imediate ishte rendi, qetësia dhe siguria e brendshme. Rendi dhe qetësia ishte një prej obligimeve themelore të qeverisë së Vlorës. Ndjenja patriotike ishte pishtari i ndezur i atdhetarisë për t'u mbrojtur nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme. Policia e Shtetit është struktura që e kërkon koha në të gjitha epokat. Krijimi i policisë së shtetit për herë të parë u bë bazuar në vizionin e themeluesit të shtetit, i cili në ditët e para të 1913-ës thoshte: "...siguroni sa më mirë qetësinë e vendit dhe rendin publik...", porosiste Kryeministri Ismail Qemali prefekturat dhe bashkitë e vendit. Për herë të parë në një qeveri shqiptare nisi të funksiononte Zyra e Sigurimit Publik, që thënë ndryshe ishte Drejtoria e Policisë Shqiptare, me detyra administrative dhe gjurmuese, ndërkohë që shkollimi ngeli një ide në letër. Më 13 janar 1913, Qeveria e Përkohshme e Vlorës mori vendimin për krijimin e Forcave të Rendit, të Policisë dhe Xhandarmerisë, (AQSH, Fondi dokumentar 245/II, D.69, f1). Detyrat e Kryeministrit të parë dhe Kuvendit të Vlorës, për rend e qetësi publike do kryheshin nga xhandarmëria që kryente funksione të policimit dhe drejtohej nga Sali Vranishti, Alem Tragjasi, Hysni Toska, Hajredin Hekali. Në funksionin administrativ policor, drejtor i parë ishte Halim bej Gostivari. Katër muaj më vonë, më 4.5.1913 u krijua Shtabi madhnuer, që varej xhandarmëria me tre batalione: të Vlorës, Beratit e Elbasanit. Më 3.6.1913 u miratua "Rregullorja e Milicisë shqiptare të Qeverisë së Përkohshme të Vlorës", një dokument i rëndësishëm për kohën. Në një periudhë prej një shekulli dhe njëmbëdhjetë vjet Policia e Shtetit ka pasur historikun e zhvillimit, në përputhje me politikat shtetërore të disa regjimeve republikane, monarkike, socialiste e demokratike, në periudha edhe nga më komplekset. Policia ka qenë domosdoshmëri jetike e shtetit, kërkesë e publikut, për misionin themelor në shërbim të rendit, qetësisë, sigurisë, komunitetit, zbatueshmërinë ligjore. Organizimi i parë i Policisë u bë në bazë drejtorie ishte me qendër në Vlorë. Drejtuesi i parë i policisë shqiptare në shtetin e Ismail Vlorës



POLICIA SHQIPTARE ËSHTË NË KRAH TË POLICIVE MODERNE EVROPIANE, E BARABARTË NË FRONTIN KUNDËR KRIMIT. POLICIA SOT KA POTENCIALET INTELEKTUALE E PROFESIONALE QË JANË TË NIVELIT DHE STANDARDEVE QË SIGUROJNË EFIKASITET TË LARTË NË PËRMBUSHJEN E MISIONIT TË SAJ, NË PËRMBUSHJE TË KRYERJES SË DETYRIMEVE LIGJORE E PROFESIONALE TË PËRGJEGJËSIVE, SI NË FUSHËN E KRIMIT TË ORGANIZUAR ASHTU EDHE NË ATË TË POLICIMIT NË TËRËSI.

ishte Halim Gostivari nga Gjakova, më tej Fehmi Mezhgorani nga Tepelena. Fakt është se, Policia Shqiptare është ngritur nga vetë shqiptarët dhe më vonë edhe është mbështetur e këshilluar nga ekspertë e specialistë holandezë e më tej britanikë, edhe pse është ruajtur tiparet, identiteti i misionit civil të Policisë, formati i evropian, por dhe me norma juridike për gjurmimin, hetimin, arrestimin, mbrojtjen e të drejtave e të lirive të individit, ndalimet e hyrjeve me forcë në shtëpitë e qytetarëve, grumbullimet pa armë etj.

Ekspierienca botërore e policimit dhe fryma e re e policimit në Shqipëri

Detyra emergjente e sigurisë së brendshme të shtetit, strukturimi mbi bazën e eksperiencave botërore të policimit ishte parësore për kohën. Ndërkohë që evropianët, ballkanasit dhe më gjerë kishin dekada që ecnin në "shinat" e sigurisë së brendshme të shteteve. Evropianët e njihnin anglezin Robert Peel, nismëtarin për miratimin mbretëror britanik të Aktit të Policisë Londineze të 19 qershorit 1829. Ai vendosi policinë e Londrës nën kontroll si një zgjidhje për shkak të frikës së publikut në lidhje me vendosjen e forcave të ushtrisë në çështjet e brendshme. Sekretar i Brendshëm Robert Peel ishte i pari në botë që organizoi forcën policore përgjatë linjave civile, në vend se forcave paramilitare. Për t'u dukur neutrale, uniforma ishte porositur

e prodhuar qëllimisht në ngjyrë blu, sesa e kuqe, e cila ishte atëherë një ngjyrë ushtarake. Bashkë me oficerët të armatosur vetëm me një shkop druri dhe një raketë sinjalizuese për nevojën për ndihmë në rast rreziku. Radhët e policisë për kohën nuk përfshinin tituj ushtarakë, me përjashtim të gradës së rreshterit. Forca policore prej 1000 djemsh, ose "Bobsat", për nder të krijesit të tyre, Robertit, nuk mbante armë zjarri, edhe pse Robert Peel autorizoi Komisionerin të blinte pesëdhjetë pistoleta xhepi, për t'u përdorur në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhet për rastet e përdorimit të armëve të zjarrit. Karakteristikat e bobsave ne sytë e publikut ishin "helmëta, shkopinj, bilbili". Në Londër dhe jo vetëm vjedhjet ose thyerjet e shtëpive, ishte një problem i zakonshëm për policinë. "Shkelësit e shtëpive" ishin zakonisht të armatosur. Atëherë ishte gjithashtu e ligjshme, sipas projektligjit të të drejtave, për anëtarët e publikut që ishin protestantë, siç ishin shumica, të zotëronin dhe të përdorin armë të zjarrit. Pas vdekjes së oficerëve me armë zjarri në rrethet e jashtme të metropolit dhe debatit publik për armatosjen e forcës, Komisioneri i kërkoi Robert Peel për autorizim për të furnizuar oficerët në rrethet e jashtme me revolverë. Autorizimi u dha me kushtin që revolverët të lëshoheshin vetëm nëse, sipas mendimit të oficerit të lartë, oficerit mund t'i besohej ta përdorte me siguri dhe me përgjegjshmëri të lartë. Robert Peel në mendjen

e njerëzimit ka ngelur si “babai” i policisë së botës.

Eksperiencia britanike u përhap në mbarë botën, edhe në Shqipëri, që kishte aspirata të mëdha të shtet-formimit. Tiparet e policimit në vendin tonë i përhapu edhe grupi i xhandarmërisë holandeze me De Veerin në krye. Pas viteve ’20-të vështrimi u hodh edhe përtej kufirit administrativ shqiptar dhe në maj 1923, kolonel Sterling mbërriti në Shqipëri. Më 29.9.1926, vendin e inspektorit të përgjithshëm, që mbante gjenerali anglez Frank W. Sterling e zuri gjenerali anglez Perssi. Më 1933, në krye të Xhandarmërisë ishte nënkolonel Shefki Shatku, oficer i përgatitur dhe i arsimuar në kohën e mbretërisë së brishtë shqiptare në ndihmë të Xhandarmërisë, kishte në dispozicion gjeneralin anglez në pension Perssi. Policimi në Shqipëri kishte kaluar në rrugë “të pashkelura”. Misionin e policimit e kryente Garda dhe Xhandarmëria shqiptare, si elemente të sigurisë së brendshme deri në prill 1939, kur pushoi funksionin me pushtimin e vendit. Misioni i policimit i Xhandarmërisë, më 1936 kishte një kolonel, katër nënkolonelë, 8 majorë, 16 kapitenë të I, 32 kapitenë të II, 40 togerë, 43 nëntogerë, 144 oficerë gjithsej me buxhet të përgjithshëm 3.250.000 franga ari.

Policimi shqiptar në periudhën e pavarësisë së dytë të Shqipërisë

Vitet ’20 janë vitet ku vendosej ardhmëria e shtetit shqiptar. Kongresi i Lushnjës, Lufta e Vlorës dhe pas konferenca e Versajës, ishin ngjarjet ku shqiptarët kaluan momentet më të rëndësishme historike të shtet-formimit. Më 1919-1920, qeveria rivlerësoi rëndësinë e Policisë. Ajo organizoi Drejtorinë e Përgjithshme të Qetësisë Botore dhe u dha kompetenca nënprefekturave e prefekturave që të organizojnë zyrat e Policisë dhe të caktojnë policët në detyrë. Strukturat e Policisë në atë kohë u shtrinë në 14 nënprefektura, që kishte një efektiv prej 5 komisarësh, 8 nën komisarësh dhe 43 policësh, që ishin emërtuar “komiseri”. Ishte hera e parë në historikun e saj, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë pati buxhetin e saj, që në nëntor 1919, buxhet u rrit 30%, më 1920. Paga e punonjësve të policisë shënonte rritje me argumentin e përmirësimit të gjendjes dhe rritjen ndërgjegjësimitin e policëve të shtetit të rilindur shqiptar. Viti 1920-të ishte viti i riorganizimit të Policisë shqiptare me drejtori policie në prefektura dhe shtimin e limitit organik të saj. Drejtorë të rinj të policisë dhe komisarë policie të rinj ishin sikurse administratorët vendorë e drejtuesit në strukturat e xhandarmërisë, ushtrisë e milicisë. Më 1921 roli i Policisë u fuqizua dhe iu kushtua kujdes i posaçëm i aftësimit për kryerjen e veprimeve procedurale që në çastin e njoftimit për ngjarjen, ndjekjen me shumë përgjegjësi të ngjarjeve kriminale dhe dokumentimin rigoroz të tyre në një raport në çdo dy javë. Kontrolli i territorit ishte detyrë bazale. Në metodën e policimit u kufizua e drejta e veprimit arbitrarisht ndaj individëve.

Republika e parë, Mbretëria dhe paslufta e Dytë Botërore në Shqipëri

Policimi shqiptar në gjysmë shekulli (1920-1990) eci në tre regjime. Në vitet 1927, 1928 u bënë përpjekje për organizimin e Policisë Shqiptare sipas modelit italian, për zbatim të ligjit për Administratën Civile, duke synuar dhënien e të gjithë kompetencave prefektit për kontrollin e policisë. Në dhjetëvjeçarin 1928-1938 policia dhe xhandarmëria ka pasur zhvillime pozitive, ku futën elementë modernë perëndimorë në fushën e strukturave dhe legjislacionit të policisë e xhandarmerisë; krijohen për herë të parë, policia bashkiake më 1928, policia rurale më 1929, policia kufitare më 1930, policia e sigurimit publik më 1938, roja mbretërore e kufirit më 1939, xhandarmëria qytetase me atributet e policisë urbane, etj. Periudha e viteve 1939-1944 ishte në peshën e LIIB, ndërsa Policia në më të shumtën ishte strukturë e qetësisë e rendit në rrethana specifike të luftës. Fillimisht ajo ishte pjesë e trupës së armatosur e Policisë në Shqipëri, në varësi të kryesisë së Këshillit të Ministrave, por e inkuadruar në trupën policore të Mbretërisë së Italisë. Në strukturën organizatave spikatin Drejtoria Qendrore e Sigurimit Publik, zyrat e prefekturave, zyrat në nënprefektura dhe zyrat e kufirit dhe të post-porteve tokësore e detare. Gjatë LIIB strukturat e policisë e xhandarmërisë në pjesën me të madhe u asimiluan dhe u profilizuan sipas interesave të shteteve pushtuese. Gjatë pushtimeve italiane dhe gjermane, policia u integrua në strukturat ushtarake me emërtimin “Trupa e Armatosur e Policisë”. Për periudhën e pushtimit Italian policia ishte në mbikëqyrjen e këshilltarit të përhershëm të policisë italiane dhe shumë funksionarëve të tjerë italianë. Kjo periudhë pati

fuqizim të policisë, rritje të përgjegjësive. Më 1943, në zonat e çliruara, u krijuan strukturat partizane për ruajtjen e rendit e qetësisë publike: Komandat e Qarkut, Komandat e Vendit dhe rojet vullnetare. Pas LANÇ-it organizimi e strukturimi i policisë është bërë sipas modeleve lindore. Çlirimi nga pushtimi nazifashist i vendit solli politika të reja në misionin dhe funksionin e policisë. Bërthamat e njësive policore të krijuara në zonat e çliruara gjatë luftës ishin të gatshme të merrnin përgjegjësinë e mbajtjes së qetësisë. Më 14 maj 1945, u bë riorganizimi zyrtar i ri i policisë, për gjithë strukturat ushtarake të komandave të qarqeve dhe njihet si krijimi i Policisë Popullore, si strukturë e MPB, që varej nga Drejtoria e Policisë dhe në periudhën 1946-1948 limiti organik ka variuar nga 2286 deri në 3766 vetë. Deri më 1982 limiti organik i Policisë së Shtetit ka qenë i pandryshueshëm në shifra, ndërsa zhvillimet ndërkombëtare dhe ato të brendshme ndikuan në rritjen e limit organik të Policisë. Më 1991 shifra e punonjësve të rendit arriti në 21 000 punonjës. Në fillimin e këtyre viteve kanë zanafillën krijimin e strukturave të forcave speciale, shtimi i masave të shumta të sigurisë për VIP-at dhe rritja e numrit të policisë kufitare.

Siguria e brendshme, demokracia dhe arsimimi policor në tre dekada

Vendosja e demokracisë në Shqipëri u shoqërua me reformim, ristrukturim për personelin, standardet e policimit dhe përmirësimin e infrastrukturës policore. Rugëtimi 111-vjeçar i Policisë Shqiptare, lidhet me obligimin moral e shpirtëror, të përulemi në shenjë të thellë nderimi e respekti para varrezave,



lapidarëve, memorialëve të punonjësve të Policisë të rënë në krye të detyrës, në emër të sakrificës sublime në përmbushje të misionit ligjor për të garantuar rendin e qetësinë publike në Shqipëri.

Gjithë piramida shtetërore duhet të kuptojë dhe mirëkuptojë, por edhe nderojë, gjithë ata që mbrojtën jetën e njerëzve me jetët e tyre. Prandaj mirënjohja për “gjakun e policisë që është gjak i shtetit” duhet të jetë në themelin e veprimtarisë zhvilluese në sigurinë publike në vend. Në një shekull e njëmbëdhjetë vite të ekzistencës së Policisë shqiptare vlen nderimi dhe vlerësimi i pjesëmarrësve të ndershëm të Policisë, të gjithë ata që kontribuan dhe sakrifikuan në përballje me elementët kriminalë, në çdo skaj të atdheut, larg familjeve, në kushte jo të favorshme pune e jetese, por me bindjen e brendshme dhe pasionin e lartë për t’i shërbyer me rigorozitet ligjit, mbrojtjes së jetës së qytetarëve me jetën e tyre dhe garantimit e të ardhmes së qetë e të sigurt në Shqipëri. Policia Shqiptare është në krah të policive moderne evropiane, e barabartë në frontin kundër krimit. Policia sot ka potencialet intelektuale e profesionale që janë të nivelit dhe standardeve që sigurojnë efikasitet të lartë në përmbushjen e misionit të saj, në

përmbushje të kryerjes së detyrimeve ligjore e profesionale të përgjegjësive, si në fushën e krimit të organizuar ashtu edhe në atë të policimit në tërësi. Policia e Shtetit sot ka një bazë të sigurt të arsimimit modern, të kualifikimit dhe trajnimeve që është Akademia e Sigurisë, tashmë edhe e akredituar zyrtarisht në pikëpamje institucionale dhe programore, për FSH dhe për KPFP. AS-ja ka 34 marrëveshje bashkëpunimi me jashtë dhe brenda vendit. Në ligjin për Policinë e Shtetit, nr. 108/2014, në nenin 37, parashikohet që Policia të ketë institucionin e saj arsimor përgjegjës për formimin, specializimin dhe kualifikimin e punonjësve të Policisë së Shtetit të nivelit operues, administrativ e menaxherial. VKM nr. 185, datë 25.2.2015, krijoi Akademinë e Sigurisë, përgjegjëse edhe për edukimin dhe trajnimin e punonjësve të strukturave të tjera të sigurisë në vend. Për herë të parë ka Rektor të dekretuar nga Presidenti i RSH-së. AS-ja ka në dispozicion Qendrën Kërkimore Shkencore dhe të Projekteve, që ka realizuar disa projekte kërkimore shkencore, konferenca shkencore ndërkombëtare e kombëtare, publikuar 32 revista shkencore “Policimi dhe Siguria”. Akademia e Sigurisë është institucioni unik që punon fort për përmbushjen e misionit dhe të vizionit, ku veprimtaria në fushën e edukimit dhe kërkimit shkencor është vlerësuar në vijimësi nga publiku dhe autoritetet më të larta të ekzekutivit, MB-ja dhe DPPSH-së. Misioni themelor i Akademisë së Sigurisë është zhvillimi dhe transmetimi i dijeve me anën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në fushën e rendit dhe sigurisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të Policisë së Shtetit dhe të

strukturave të tjera ligj-zbatuese. Përgatitja dhe edukimi policor është përparësi e programit politik të qeverisë dhe MB-së si dhe e PSH-së si një aset i pazëvendësueshëm për ardhmërinë në luftë ndaj krimit, rendit e sigurisë publike. Arsिमimi policor është në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe ligjit për policinë e shtetit, mirëkuptues e institucional. Strukturat e Policisë së Shtetit janë plotësisht të inkurajuara nga partnerët ndërkombëtarë, është në bashkëpunim të ngushtë me shumë institucione ligj-zbatuese dhe ka standarde e kapacitete për të realizuar metodat bashkëkohore të hetimit; kanë në dispozicion teknologjinë e informacionit dhe aplikon sistemet bashkëkohore në strukturat e policimit. Policia e Shtetit meriton nderim e mirënjohje në këtë përvjetor të rrugëtimit të saj përmes flakëve të përzhitura të krimit dhe triumfeve mbi vështirësitë. Policia shqiptare po shpalos profesionalizëm, vlera njerëzore dhe meriton mirënjohjen e publikut. Policia përbëhet nga djem e vajza të popullit nga të gjitha trevat shqiptare dhe janë mbrojtësit e jetëve njerëzore, në shërbim të qytetarit, të ruajtjes së rendit e qetësisë publike, në zbatimin të ligjit në Shqipëri.

Uji i ambalazhuar në shishe plastike, shumë më i dëmshëm nga sa mendojmë

Nuk është sekret që përballja me plastikën është një nga problemet më të mëdha kur bëhet fjalë për mjedisin. Megjithatë, diçka që shumica e njerëzve përdorin çdo ditë mund të jetë shumë më e dëmshme sesa mendohej më parë.



Është brenda nesh

Në vitet e fundit, shkencëtarët janë alarmuar nga prania e mikroplastikës brenda trupit të njeriut. Një studim nga Shkolla Mjekësore "Hull York" në Angli madje gjeti mikroplastikë në mushkëritë e njeriut.

Një mënyrë se si këto grimca plastike po gjejnë një rrugë për të hyrë brenda jush? Shishja e ujit.



Më e lartë se sa mendohej më parë

Një studim i ri i publikuar nga "Proceedings of the National Academy of Sciences" konfirmon se numri i mikroplastikës në shishet plastike është shumë më i lartë se sa mendohej më parë.



Mbi 240,000 fragmente të molekulave plastike

Sipas "France24", shkencëtarët nga universitetet "Columbia" dhe "Rutgers" kanë zbuluar mesatarisht 240,000 fragmente të molekulave plastike për litër në disa marka të njohura uji, mbi 100 herë sesa vlerësimet e mëparshme.



Shkencëtarët e kanë ditur prej vitesh

Shkencëtarët e dinë prej vitesh se në ujin e ambalazhuar ka mbetje plastike. "CBS News" nxjerr në pah një studim të vitit 2018 që vendosi mesatarisht rreth 300 grimca plastike në ujë.



Rreziqet e mikroplastikës

Rreziqet shëndetësore mbeten për t'u studiuar. Në vitin 2019, Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi se rreziqet e mikroplastikës vinin në tre forma: vetë grimcat, kimikatet nga të cilat përbëhen grimcat dhe mikroorganizmat që mund të evoluojnë nga mikroplastika.

Në atë kohë, përfaqësuesit e OBSH-së argumentuan se rreziku i shkaktuar nga mikroplastika ishte shumë i ulët, por kjo nuk do të thotë se mund të zbulohen rreziqe të reja në të ardhmen.




Alternativa të tjera përveç shisheve plastike

"Nëse njerëzit janë të shqetësuar për nanoplastikën në ujin e ambalazhuar, është e arsyeshme të konsiderohen alternativa si uji i rubinetit", - deklaron profesori nga "Columbia" Beizhan Yan dhe bashkëautori i studimit.

Më pak se pesë milimetra

"National Geographic" shpjegon se mikroplastikat janë mbeturina të vogla që zakonisht vijnë nga plastika më të mëdha. Ato janë më të vogla se pesë milimetra (0,1 inç) në madhësi.



Mikroplastika është kudo

Sipas "The Guardian", mikroplastika është praktikisht e pashmangshme sot. Gjendet në ajrin që thithni, lëngjet që pini, ushqimin që hani, ato janë të pamundura për t'u shpëtuar.

Mikroplastikët zakonisht gjenden në shishe, ambalazhe, veshje dhe spango dhe në përgjithësi janë prej najloni, polietileni dhe rrëshira.

Plastikë e përhershme

Ashtu si plastika e zakonshme, atyre u duhen qindra vjet për t'u dekompozuar, që do të thotë se ato do të zgjasin shumë më gjatë se sa të jetojnë duke qenë se përfundojnë brenda.

Det prej plastike

Jeta detare është shumë e ekspozuar ndaj mikroplastikës, të cilat zakonisht përfundojnë të konsumuara nga njerëzit, duke krijuar një tubacion të drejtpërdrejtë që këto grimca të përfundojnë brenda jush.

Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar... ende...

Në pjesën më të madhe, ato zakonisht derdhen me pjesën tjetër të mbeturinave njerëzore. Megjithatë, mbetet për t'u parë se çfarë lloj problemesh shëndetësore mund të krijojnë mikroplastika në të ardhmen.

OpenAI heq dorë nga premtimi për të mos përdorur teknologjinë për qëllime ushtarake

Prodhuesi i “ChatGPT” ka lehtësuar një ndalim për përdorimin e teknologjisë së tij të inteligjencës artificiale për të ndihmuar në zhvillimin e luftës, duke nxitur spekulimet se mund të kërkojë lidhje me ushtrinë amerikane. “OpenAI” ka dobësuar gjuhën në lidhje me politikat e saj të përdorimit, pasi kishte thënë më parë se do të parandalonte përdorimin e AI-së për “aktivitete që kanë një rrezik të lartë dëmtimi fizik”, si zhvillimi i armëve dhe përdorimet ushtarake. Një version i ri i politikës ka hequr referencën për përdorimin e AI për “ushtarakë dhe luftë”, megjithëse ruan ndalimin e zhvillimit të armëve.

Ndryshimi, i bërë javën e kaluar, është interpretuar si një zbutje e bllokut të kompanisë për përdorimin e teknologjisë AI për përdorime ushtarake.

Kompania tha se kishte përditësuar politikat e saj për shkak të punës në projektet e sigurisë kombëtare. Investitori më i madh i “OpenAI”, “Microsoft” është një furnizues kryesor i Departamentit të Mbrojtjes së SHBA (DoD).

DoD ka eksperimentuar me modele të avancuara të inteligjencës artificiale si “ChatGPT” dhe “Bard”, ndërsa Ministria e Mbrojtjes ka krijuar një Qendër të Mbrojtjes së AI-së për të parë mënyrat e vendosjes së teknologjisë. Një zëdhënës i OpenAI tha për uebsajtin amerikan “The Intercept” se politikat e saj ishin shkruar për t’i bërë ato “më të qarta” dhe “më të lexueshme”.

Kompania shtoi: “Politika jonë nuk lejon që mjetet tona të përdoren për të dëmtuar njerëzit, për të zhvilluar armë, për mbikëqyrjen e komunikimeve, ose për të lënduar të tjerët ose për të shkatërruar pronë.”

“Megjithatë, ka raste të përdorimit të sigurisë kombëtare që përputhen me misionin tonë. Për shembull, ne tashmë po punojmë me DARPA për të nxitur krijimin e mjeteve të reja të sigurisë kibernetike për të siguruar softuer me burim të hapur, nga i cili varen infrastruktura kritike dhe industria.

“Nuk ishte e qartë nëse këto raste të



përdorimit të dobishëm do të ishin lejuar nën termin “ushtarake” në politikat tona të mëparshme. Pra, qëllimi me përditësimin e politikave tona është të ofrojmë qartësi dhe aftësi për të pasur këto diskutime.”

Ushtarakët në mbarë botën po përfitojnë gjithnjë e më shumë nga AI-ja për të zhvilluar armë dhe simuluar luftën, ndërsa përpiqen të

fitojnë një avantazh në fushën e betejës.

Të ashtuquajturat modele të gjuhëve të mëdha si “ChatGPT” nuk e kanë këtë aftësi, por mund të përdoren potencialisht për planifikimin ushtarak, një opsion që ushtria amerikane e ka testuar.

Microsoft tha vitin e kaluar se departamentet qeveritare që përdorin shërbimin e saj të

kompjuterit cloud, i cili përfshin Departamentin e Mbrojtjes së SHBA-së, mund të kenë akses në teknologjinë “OpenAI”.

Kompanitë e teknologjisë shpesh kanë luftuar për t’u pajtuar me shitjet në departamentet ushtarake.

“Google” pësoi një revoltë të stafit për punën e tij me Pentagonin për të zhvilluar sisteme AI për dronët, gjë që përfundimisht e çoi atë në mbylljen e projektit.

Kompanitë AI “Palantir” dhe “Scale” po punojnë të dyja në sistemet e vendimmarrjes së AI-së për ushtrinë amerikane.

Studiuesit në Institutin e Teknologjisë në Georgia, Universitetin “Stanford”, Universitetin “Northeastern” dhe “Hoover Wargaming and Crisis Simulation Initiative” zbuluan në fillim të këtij muaji se modelat e AI-së të vendosura në simulimet e lojërave luftarake priren të përshkallëzojnë konfliktet.

Në vijim aksionet e kompanisë kineze të teknologjisë “Baidu” ranë me 11.5 për qind pasi raportet thanë se shërbimi i saj AI “Ernie” po përdorej nga ushtria kineze, duke çuar në frikën se Uashingtoni mund të kërkonte të hakmerrej kundër kompanisë.

“Baidu” mohoi çdo lidhje me Forcën Mbështetëse Strategjike të Ushtrisë Çlirimtare Popullore, por raporti në “South China Morning Post” të Hong Kongut çoi në shqetësime se SHBA mund të lëshonte kufizime të mëtejshme për aksesin e kompanive kineze në teknologji si gjysmëpërçuesit e avancuar.

Parashikimi alarmues: AI-ja mund të zëvendësojë potencialisht njerëzit në të gjitha punët deri në vitin 2116

Sondazhi i fundit i kryer nga gjashtë akademikë nga Universiteti i Oksfordit, së bashku me institucionet në SHBA dhe Gjermani, ka ngritur shqetësime në lidhje me përparimin e shpejtë të inteligjencës artificiale (AI). “Anketa e Ekspertëve 2023 mbi Progresin në AI” mblodhi përgjigje nga më shumë se 2,700 studiues dhe pjesëmarrës në konferencat kryesore të AI-së, duke zbuluar se zhvillimi i AI-së po përparon më shpejt sesa ishte parashikuar fillimisht. Sipas studimit, ekziston një shans 50% që AI-ja të mund t’i tejkalojë njerëzit në shumicën e detyrave brenda një dekade, dhe deri në vitin 2116, makinat mund të shkëlqejnë në të gjitha rolet, duke zëvendësuar potencialisht punëtorët njerëzorë në çdo profesion. Ky afat kohor është gati 50 vjet më herët se parashikimet e mëparshme.

Përparim i shpejtë në zhvillimin e AI-së

Pjesëmarrësit e sondazhit, të përbërë nga studiues që kishin publikuar në ambiente të nivelit të lartë të AI-së, shprehën një konsensus se zhvillimi i AI-së po përshpejtohet. Ata besonin se AI-ja mund të tejkalonte aftësitë njerëzore në detyra të ndryshme, duke filluar nga palosja e rrobave deri te kryerja e aktiviteteve komplekse si instalimi i instalimeve elektrike në shtëpi, shumë më shpejt se sa pritej. Gjetjet e sondazhit sugjerojnë se revolucioni i AI-së mund të jetë më i afërt se sa ishte parashikuar më parë.

Parashikimi alarmues se AI-ja mund të zëvendësojë potencialisht njerëzit në të gjitha punët deri në vitin 2116, ka ngritur shqetësime të mëdha. Studimi tregon se makinat mund të punojnë në mënyrë më efikase dhe me kosto efektive sesa njerëzit në pothuajse çdo profesion brenda shekullit të ardhshëm. Ky përparim i shpejtë në teknologjinë e AI-së ka shkakuar tashmë paralajmërime nga institucione si “Goldman Sachs”, e cila vlerëson se deri në 300 milionë vende pune në mbarë botën janë



në rrezik për shkak të automatizimit dhe AI-së.

Potenciali i AI-së për të krijuar dhe shkatërruar vende pune

Ndërsa perspektiva e AI që zëvendëson punëtorët njerëzorë në role të ndryshme është

shqetësuese, disa ekspertë argumentojnë se AI-ja mund të krijojë gjithashtu mundësi të reja pune. Forumi Ekonomik Botëror parashikon që AI-ja do të gjenerojë 12 milionë më shumë vende pune sesa do të zëvendësojë në vitet e ardhshme. Kjo

perspektivë sugjeron se ndërsa disa profesione mund të bëhen të vjetëruara, mund të shfaqen role të reja të zhvillimit, mirëmbajtjes dhe mbikëqyrjes së AI-së.

Sondazhi i kryer në vitin 2023 zbuloi një sërë mendimesh midis shkencëtarëve në lidhje me ritmin e zhvillimit të AI-së dhe ndikimin e saj të mundshëm në shoqëri. Përafërsisht 35% e të anketuarve besojnë se AI-ja duhet të përparojë me një ritëm më të ngadaltë ose më të shpejtë se sa është aktualisht, ndërsa 27% mendojnë se norma aktuale ishte e përshtatshme. Këto këndvështrime të ndryshme vijnë nga individë brenda fushës, duke theksuar natyrën komplekse të evolucionit të AI.

Optimizëm dhe shqetësime

Mbi gjysma e pjesëmarrësve në anketë shprehën optimizëm për ndikimin pozitiv të AI-së në njerëzimin. Megjithatë, një pakicë e konsiderueshme ngriti shqetësime për pasojat e mundshme negative. Shqetësimet përfshijnë mundësinë e zhdukjes së njerëzve, përhapjen e lajmeve të rreme, krijimin e përmbajtjeve të rreme dhe potencialin për kontroll autoritar përmes teknologjisë AI. Këto shqetësime pasqyrojnë dilemat etike dhe shoqërore të paraqitura nga avancimi i shpejtë i AI-së.

Gjetjet e sondazhit tregojnë se inteligjenca artificiale po përparon me shpejtësi, duke rritur mundësinë që makinat të zëvendësojnë njerëzit në role të ndryshme më shpejt se sa pritej. Ndërsa ka optimizëm për potencialin e AI-së për të krijuar mundësi të reja pune, shqetësimet rreth ndikimit të saj shoqëror dhe implikimeve etike vazhdojnë. Ndërsa AI vazhdon të evoluojë, bëhet gjithnjë e më e rëndësishme për shoqërinë që të adresojë këto sfida dhe të vendosë një ekuilibër midis përparimit teknologjik dhe mirëqenies së njerëzimit. Zhvillimi i vazhdueshëm i inteligjencës artificiale do të formësojë padyshim të ardhmen e punës dhe shoqërisë.

Më 17 janar 1468, u nda nga jeta heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu. Ai është Heroi Kombëtar dhe figura më e shquar në historinë e shqiptarëve. Gjergj Kastrioti e kaloi jetën në fushë-betejë ballë për ballë me fuqinë më të madhe të kohës dhe me sukses mbrojti territoret arbërore. Për një periudhë kohore prej 25 vjetësh, Kastrioti zhvilloi rreth 30 luftëra të ashpra në Arbëri dhe ushtria e tij arriti fitore të bindshme kundër forcave osmane...

...Skënderbeu sintetizon një epokë të tërë historike që mori emrin e tij: luftën njëshekullore kundër pushtimit osman. Ai u lind më 6 maj të vitit 1405 dhe vdiq më 17 janar të vitit 1468.

Gjergj Kastrioti ishte djali më i vogël i Gjon Kastriotit dhe i princeshës Vojsava, fëmija i fundit mes 4 djemve dhe 5 vajzave. Në moshën 9-vjeçare u dërgua në oborrin e Sulltanit në Adrianopojë. Natyra i kishte dhënë dhunti mendore e fizike. Zgjuarsia dhe shkathësia e çuan në shkollën e içogllanëve, që përgatiste komandantë e nëpunës. Atje mori emrin “Iskënder” i barasvlershëm me emrin Aleksandër. Pas mbarimit të shkollës, Gjergj Kastrioti kreu detyra ushtarake në Ballkan e në Azinë e Vogël, duke u dalluar për trimëri dhe për këtë arsye iu dha titulli “bej”. Emri “Skënderbej” në turqisht do të thoshte “Princi Aleksandër”. Me vdekjen e të atit, ai shpresonte t’i zinte vendin, por në fakt sulltani e emëroi sanxhakbej jashtë tokave shqiptare. Skënderbeu nuk hoqi dorë nga ideja për t’u kthyer në Shqipëri.

Më 3 nëntor 1443, në afërsi të Nishit, u ndeshën ushtria osmane dhe ajo hungareze e drejtuar nga Janush Huniadi. Ushtria osmane u shpartallua dhe u tërhoq në panik. Skënderbeu nisi planin e kryengritjes, së bashku me 300 kalorës shqiptarë e me të nipin, Hamza Kastrioti, u kthye në Dibër. Populli e priti si çlirimtar. Mori masa për përforsimin e rrugëve nga mund të vinin osmanët, dhe prej andej iu drejtua Krujës. Me një ferman të rremë shtiu në dorë qytetin e garnizonin dhe kështu, më 28 nëntor 1443, u shpall rimëkëmbja e principatës së Kastriotëve. Mbi kështjellën e Krujës u ngrit flamuri me shkabën e zezë dykrenore. Fjalimi i Skënderbeut nxiti frymën atdhedashëse. Kryengritja çlirimtare u bë e përgjithshme. Gjatë dhjetorit, Shqipëria e Mesme dhe e Veriut u spastruan nga forcat osmane. Skënderbeu ishte organizatori i Kuvendit të Arbrit, në të cilin u zgjodh si prijës i Lidhjes Shqiptare të Lezhës. Ai u martua me të bijën e Gjergj Arianitit për të forcuar lidhjet e tij me principatat e tjera.

Nën udhëheqjen e Gjergj Kastriotit, lufta e shqiptarëve u ngrit në një shkallë më të lartë e më të organizuar dhe shënoi një kthesë vendimtare në zhvillimin politik të Shqipërisë. Skënderbeu zhvilloi luftë mbrojtëse, dhe për 25 vjet, mes viteve 1443-1468, ushtria e tij prej 10 000 anëtarësh luftoi e fitoi kundër forcave osmane, me një ushtri disa herë më e madhe se ajo shqiptare. Në vitin 1451, nënshkroi një traktat me Alfonsin e Napolit për të siguruar një aleancë mbrojtëse, edhe pse ai mbeti një sundimtar de facto i pavarur. Në vitet 1460–61, ai mori pjesë në luftërat civile të Italisë në mbështetje të Ferdinandit I të Napolit. Në vitin 1463, ai u bë komandanti kryesor i forcave kryqtare të papa Piut II, por papa vdiq, ndërsa ushtritë ende po mblidheshin. Së bashku me venedikasit ai luftoi kundër osmanëve gjatë Luftës osmano-venedikase të viteve 1463–79. Aftësitë ushtarake të Skënderbeut përbënin një pengesë të madhe për zgjerimin osman. Ai u konsiderua nga shumë njerëz në Evropën Perëndimore si një model i rezistencës.

Gjergj Kastrioti ishte përfaqësuesi më konsekuent dhe më i shquar i elitës drejtuese shqiptare, që udhëhoqi më vendosmëri frontin e luftës së shqiptarëve kundër pushtuesve osmanë. Ai realizoi të parin bashkim të shqiptarëve, Lidhjen Shqiptare të Lezhës, e cila hapi rrugën e krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, themeluesi i të cilit u bë ai vetë. Kujdes të veçantë Skënderbeu i kushtoi ruajtjes së burimeve të brendshme ekonomike, tek të cilat u mbështet lufta. Duke fuqizuar mbrojtjen në brezin kufitar, në lindje e në jug, ai i dha mundësi banorëve të viseve të lira të zhvillonin një veprimtari ekonomike deri diku normale. Krahas mbrojtjes së vendit, Skënderbeu i kushtoi vëmendje çlirim të viseve të pushtuara që ndikoi në formimin e mëtejshëm të lidhjeve me banorët e këtyre viseve dhe në forcimin e bashkimit e të gjithë popullit shqiptar. Aftësitë e Skënderbeut si burrë shteti spikatën edhe në marrëdhëniet me vendet e tjera. Duke pasur të qartë se rrezikut osman mund t’i bëhej ballë vetëm me sukses vetëm me forca të bashkuara, Skënderbeu kërkoi pareshtur pjesëmarrjen e vendeve evropiane në luftë kundër armikut të përbashkët. Në kushtet e pabarazisë së theksuar ndërmjet forcave osmane dhe atyre shqiptare, Skënderbeu përpunoi strategjinë dhe taktikën e tij luftarake, në bazë të së cilës qëndronte mendimi se fitorja nuk mund të varej nga numri i ushtarëve. Ai mbante armikun në alarm të përhershëm, i priste

17 janar, dita e përjetësisë së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti, Skënderbeu



rrugën e fuqizimet dhe, pasi e kishte futur në kurth, e godiste me sulme të fuqishme e të befasishme.

Skënderbeu u shndërrua në simbol të luftës për liri e pavarësi, duke mbetur një figurë e dashur për shqiptarët edhe pas vdekjes së tij. Kujtimi i tij mbeti i gjallë nëpër këngët, gojëdhënat e tregimet e shumta popullore që i dhanë atij tiparet e një figure legjendare. Vepra dhe figura e Skënderbeut kishte përmasa dhe rëndësi evropiane. Ai u vlerësua lart nga personalitetet e shquara evropiane të kohës. Këtë e dëshmon edhe fakti se për Skënderbeun është shkruar një literaturë e shumëllojshme, prej qindra vëllimesh, të

botuara në shumë gjuhë, kudo në botë.

Vdekja

Në janar të vitit 1468, Skënderbeu u sëmur gjatë zhvillimit të një Kuvendi të thirrur nga ai, në të cilin ishin të ftuar të gjithë princat shqiptarë. Vdiq më 17 Janar 1468, në Lezhë. I mbuluar me lavdi, u varros në Katedralen e Shën Kollit në Lezhë, po në atë vend ku u mbajt Kuvendi i Lezhës. Shqiptarët humbën prijësin e lavdishëm që i udhëhoqi për 25 vjet rresht. E shoqja me të birin emigruan në Itali, sikurse edhe një pjesë e parisë shqiptare.

Epoka e Skënderbeut e shekullit XV dhe vetë figura e Gjergj Kastriotit ndikoi fuqishëm në jetën shpirtërore të shqiptarëve dhe për rritjen e vetëdijes kombëtare të tyre. Të frymëzuar prej tyre, intelektualë të shquar shqiptarë, i pasqyruan ato në vepra historike, në të cilat nisi jetën e vet historiografia shqiptare. Ishte Dhimitër Frangu që shkroi i pari jetën e Skënderbeut, realisht si u zhvillua, sepse Frangu ishte bashkëshoqërues i gjithë jetës dhe luftërave të Skënderbeut.

Të gjithë shkrimtarët pasardhës, u mbështeten mbi veprën e Frangut, edhe vetë Barleti. Patjetër se vepra e Barletit që u botua latinisht në vitin 1504, kushtuar luftës heroike të shqiptarëve për mbrojtjen e Shkodrës, pati jehonë të madhe. Por vepra që e lartësoi figurën e tij si historian humanist është “Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut”, të cilën e botoi italisht në Romë rreth viteve 1508-1510. Një veper tjetër e rëndësishme për të njohur shoqërinë shqiptare të shek. XV është “Historia dhe gjenealogjia e shtëpisë së Muzakajve”, shkruar në italisht, më 1510, nga bashkëluftëtari i Skënderbeut, Gjon Muzaka.





Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Brigada me dy ditëlindje

Shqipëria dhe Labëria nuk e harrojnë historinë e lavdishme të Brigadës së V Sulmuese (BrVS). Ajo ka dy ditëlindje në dy vendlindje. Baza e formimit të brigadës ishin dy batalionet “Halim Xhelo” dhe “Ismail Qemali”, me një efektiv prej më shumë se 500 luftëtarë. Në fshatin Gumenicë është lapidari që përkujton ditën e formimit të BrVS, në një kodër, si një vend strategjik nga ku shikon të gjithë zonën përreth. Prej kësaj vëzhgoje të gjitha lëvizjet e forcat armike që lëviznin në ndjekje të formacioneve partizane të zonës. Në ditën e formimit të saj në fshatin Gumenicë dhe deri në ditën e inaugurimit në Bramyshnje të Tërbaçit, më 20 janar 1944, brigada u ndesh në luftime të pandërprera të operacionin nazist që kishte filluar në luginën e Mesaplikut. Vendlindja e parë është Gumenica dhe datëlindja më 28 nëntor 1943, ku ishte emëruar komandant Abaz Shehu dhe komisar Hysni Kapo. Inaugurimin ngeli në gjysmë se u nis urgjent për në betejë kundër nazistëve e ballistëve në Luginën e Mesaplikut dhe në Dukat, ku po goditeshin partizanët prapa shpine e ku po terrorizohej populli. Për ditë e net luftimet u zhvilluan të ashpra në Dukat dhe në Gjorm, ku më 12 dhjetor 1943 bie heroikisht Abaz Shehu, komandanti i brigadës. Shefqet Peçi ka thurur vargje: Ndërmjet Gjorm e Lepenicë,/ Ku shkon lumi me furi/ Atje filloi një luftë,/ Nga xhadeja vjen ushtri./ Doli Abaz Shehu vet,/ Dha urdhër me shpejtësi,/ Gjerman bashkë më tradhtarë/ Përdorin artileri,/ Afër Gjormit më të dalë,/ Filloi një luftë e rreptë,/ Gjermanët me partizanë,/ U përdor dhe bajonetë./ Abazi mbeti i vranë,/ Komandanti vet’ i tretë,/ Partizanët kur mësuan,/ U vërsulën si shigjetë.

Vendlindja e dytë është Bramyshnje e Tërbaçit, vendi i inaugurimit të BrVS dhe datëlindja më 20 janar 1944. Komandant u emërua Shefqet Peçi dhe komisar Hysni Kapo, ndërsa zëvendës komisar Manush Myftiu e zëvendëskomandant Dervish Hekali. Sheshi i Bramyshjes u mbush me popull. Aty u rreshtuan 5 batalione partizane, ku në krye ishte shtabi i brigadës, si dhe shtabet e batalioneve, të kompanive dhe të togave me skuadrat. Organizimi ishte i një ushtrie të rregullt ushtarake. Në ditën e inaugurimit efektiv i brigadës shkoi në 900 luftëtarë. Mbi 80 për qind e partizanëve ishin të rinj e të reja.

Në ditën e inaugurimit të brigadës folën komandant Shefqet Peçi, komisar Hysni Kapo, zëvendës komisar Manush Myftiu etj. U lexua dhe përshëndetja e Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së dërguar efektivit të BrVS me rastin e inaugurimit. Në përshëndetje theksohej se brigada të jetë “brigada e flakës, e zjarrit, e luftës dhe e sulmit, si bij të denjë të Vlorës kreshnike, shkatërroni armikun dhe tradhtarët... Ju e keni parë haptazi këtë tradhti të Ballit Kombëtar”.

U krijua në kulmin e Operacionit të Dimrit 1944

Brigada u krijua në kulmin e Operacionit armik të Dimrit dhe luftoi për të përballuar mësymjen gjermano-balliste. Operacionin e Dimrit në Qarkun e Vlorës e përballoi populli dhe partizanët e BrVS. Në pasditen e inaugurimit Shtabi i Brigadës, i cili ishte në dijeni të planit të operacionit gjerman mori masa të shpejta dhe nisi repartet në drejtimet e caktuara. Ajo kreu një sërë aksionesh e betejash. Nuk kishte ditë që të mos mbetej pa një aksion. Ndër luftimet më heroike të BrVS janë luftimet e zhvilluara në Vajzë, Palasë, Vuno, Picar, Pilur, Salari, Gjorm. Brigada, jo vetëm e theu me sukses operacionin gjerman të Dimrit 1943-1944, por zhvilloi edhe një veprimtari të gjerë në popull, duke nxjerrë luftëtarë të tjerë të shumtë për plotësimin e pesë batalioneve të saj.

Urdhri i luftimeve që lëshoi Shtabi i Brigadës i vendoste forcat në këtë mënyrë: Batalionet e dytë e të katërt mbeteshin për mbrojtjen e krahinave të Vlorës, batalioni i tretë në mbrojtje të Bregdetit, kurse batalioni i parë e i pestë në mbrojtje të Kurveleshit të Sipërm nga Kaparieli deri në Salari, ku vepronte bashkë me ta edhe batalioni “Perlat Rexhepi”. Brigada zhvilloi njëzet betejë të rëndësishme dhe qindra luftime e aksione të tjera, duke i shkaktuar armikut dëme të shumta në teknikën luftarake dhe mbi pesë mijë të vranë e të zënë robër. Përballimi i operacionit armik të Dimrit 1943-1944 në kushtet

Brigada që shkroi histori ushtarake në LANÇ

(Në kuadrin e 80-vjetorit të inaugurimit të BrVS)



e motit të keq, lodhjes, urisë dhe mungesës së municioneve, ishte një provë e madhe e aftësisë së saj luftarake. Me manovrimet, ajo e goditi armikun rëndë edhe në Qishbardhë afër Vlorës, ku vritet edhe zëvendëskomandanti i Korpusit XX Gjeneral Lejtënant Dojc. Edhe operacionet e tjerë dështuan me humbje të rënda për armikun. Më 31 mars 1944, brigada u hodh në sulm të përgjithshëm në “frontin tokësor”, kështu e quanin gjermanët vijën Penkovë-Mavrovë, meqë prisnim një zbarkim të mundshëm aleat nga deti, duke u shkaktuar atyre shumë dëme. Për hakmarrje gjermanët në prill organizuan një operacion tjetër, që u prit kudo me luftë dhe që përfundoi me disfatën e tyre në Kuç. Komanda gjermane u detyrua të pohonte për repartin e saj se “trupa me një fuqi 380 vetë, me 26 mitraloza, duke mbetur siç duket pa komandë unike u shpartallua”.

Luftime dhe përvojë në fushën ushtarake

Në muajin maj 1944 brigada u përqendrua në qarkun e Gjirokastrës dhe të Përmetit, ku zhvilloi luftime dhe goditi dislokimin e formacioneve gjermane gjatë rrugës Follorinë-Janinë, luftime të rrepta në fushën e Çarshovës, goditjet që vazhduan gati çdo natë mbi forcat armike në Leskovik, Fushë Kabash, Gostivisht, Qafëzeze etj., duke e mbajtur armikun të gozhdur për ditë të tëra. Në fillim të qershorit pas një marshimi, brigada nisi sulmin mbi armikun në qafën e Gjarprit tek Guri i Prerë-Shëmbërdhenj të Gramshit e në Qafë Dardhë të Beratit. Luftimet në Qafën e Gjarprit u zhvilluan trup më trup, dhe ku armiku u detyrua të ndryshonte drejtimin e të mos shkelte dot Tomorricën. Komandanti i regjimentit të parë Alpin, i krahason këto luftime me ato të frontit të Lindjes, duke theksuar se “që prej Harkovit nuk është zhvilluar asnjë luftim analog natën”. Me thyerjen e Operacionit armik të Qershorit, brigada u nis për në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut.

Midis luftimeve të ashpra që zhvilloi në Veri ishin në Macukulli, në Qafë Muhur mbi trupat gjermane që vinin nga Dibra për të rrethuar dhe asgjësuar brigadën. Brigada me një manovër të madhe për dy javë rresht, me luftime të ashpra çau përpara në krahë e në shpinë të armikut, në drejtim të krahinës së Dibrës. Pas luftimeve, armiku u shpartallua dhe u çlirua Peshkopia. Në muajin gusht, gjermanët organizuan një operacion të gjerë, duke u nisur me forca

të mëdha nga Dibra e Madhe, Gostivari e Korabi, kundër BrVS. U çliruan me radhë Dibra, Maqellara dhe Dibra e Madhe, ku brigadë u rreshtuan 100 luftëtarë dibranë.

Luftime të tjera u zhvilluan në rrethin e Kukësit, kudo forcat partizane shpartalluan rëndë gjermanët dhe nga rrethi i Kukësit, u bashkuan me brigadën 150 luftëtarë. Në tetor-nëntor 1944 kaloi kufirin shtetëror, zhvilloi luftime të ashpra kundër nazistëve në Kosovë dhe së bashku me partizanë të Kosovës çliroi Gjakovën, Junikun, Deçanin, Prizrenin, Senicën, Priepoljen, Sanxhakun. Në Kosovë, në bashkëveprim edhe me forcat partizane kosovare, brigada çliroi Gjakovën, Prizrenin dhe gjithë Kosovën. Në radhët e saj hynë qindra vullnetarë kosovarë. Pas riorganizimit të saj me 6 batalione, BrVS marshoi në ndjekje të armikut për ta shpartalluar atë ku të gjendej deri në çlirimin e Sanxhakut. Brigada nga 1 dhjetori 1943 dhe deri më 15 mars 1945 përshkoi një rrugë luftarake prej 3.000 km nga Tërbaçi deri në Sanxhak.

Brigadë e mbuluar me lavdi

Nga kjo Brigadë ranë në fushën e nderit 357 dëshmorë të Atdheut. Dëshmori i parë i saj ishte vetë komandanti i brigadës Abaz Shehu, Heroi i Popullit. BrVS është ndër brigadat më heroike partizane, që mban titullin e lartë “Hero i Popullit” gjiri i saj ka nxjerrë 13 “Heronj të Popullit”, ku 9 ranë në betejë, ku dy midis tyre janë heroina. Ata janë: Dervish Hekali, Kastriot Muço, Zonja Çurre, Nimete Progonati, Hysen Çino, Abaz Shehu, Zaho Koka, Laze Nuro, Llambro Andoni. Shefqet Peçi, Hysni Kapo, Hito Çako dhe Rrahman Parllaku e morën titullin kur ishin gjallë.

Brigada u bë edhe një fidanishte kuadrosh drejtues në luftë e pas saj. Të tillë ishin partizanët tashmë ushtarakë të Ushtrisë si Mehmet Jaho, Nuri Arapi, Sali Ormeni, Kadri Hazbiu, Mehmet Ali Shehu, Zenel Hamiti, Çelo Arrza, Hajdar Aranitasi, Isak Lilaj, Rrahman Parllaku, Bako Dervishaj. Kuadrot e seksioni politik Hito Çako, Bilbil Klosi, Delo Balili, Andrea Varfi, Ramize Gjebea, Kadri Brahimi dhe Tanush Shyti. Heroizmi kësaj brigade është gdhendur në poezi e në këngë. Në vargjet popullore thuhet: Kur lufton Brigadë e Pestë/ Vret e pret e bën kërdi, Shefqet Peçin komandant/ Komisar shokun Hysni.

